

A close-up photograph of a hand holding a yellow pencil with a black eraser and a sharpened lead tip. The hand is positioned over a piece of light-colored paper. The background is softly blurred, showing a yellow and white pattern.

KONCEPT

PËR

**A R S I M I N
F I L L O R T Ë
T Ë R R I T U R V E**

NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



KONCEPT

PËR ARSIMIN
FILLOR TË
TË RRITURVE
NË REPUBLIKËN
E MAQEDONISË
SË VERIUT



I	Hyrje	4
II	Nevoja dhe arsyeja për Konceptim të ri për arsim fillor të të rriturve në R. e Maqedonisë së Veriut	5
III	Qëllime dhe parime të Konceptimit për arsim fillor të të rriturve në R. e Maqedonisë së Veriut	8
	III.1. Qëllime të Konceptimit arsimit fillor i të rriturve në R. e Maqedonisë së Veriut	8
	III.2. Parime të arsimit fillor të të rriturve në R. e Maqedonisë së Veriut	8
IV	Analizë e politikave dhe praktikave relevante vendore dhe ndërkombëtare	11
	IV.1. Pasqyrë e politikave dhe praktikave në UE	11
	IV.2. Pasqyrë e politikave dhe praktikave në rajonin	14
	IV.3. Analizë e dokumenteve vendore, strukturës dhe gjendjeve në kontekst të arsimit fillor të të rriturve	17
	IV.3.1. Analizë e legjislativit të vendit dhe të dokumenteve relevante për arsimin fillor të të rriturve	17
	IV.3.2. Analiza e strukturës së institucioneve relevante për arsimim të të rriturve	20
V	Parapozime themelore për avancim të arsimit fillor për të rriturit në R. e Maqedonisë së Veriut	23
VI	Propozim-model për arsim fillor për të rriturit: masa, mekanizma dhe aktivitete	24
	VI.1. Zhvillimi i sistemit të kompetencave kyçe të definuara për të rriturit në nivel të arsimit fillor, bazuar në rezultate dalëse, ose rezultate nga të mësuarit	24
	VI.2. Zhvillimi i programit mësimor të bazuar në kompetencat kyçe	26
	VI.3. Zhvillimi i sistemit të validizimit të diturisë paraprakisht të përfituar	26
	VI.3.1. Evaluim i diturisë dhe kompetencave paraprakisht të përfituara	27
	VI.4. Kapacitetet/resurset e nevojshme për implementim të qëllimeve të parapara me Konceptimin	27
	VI.5. Definimi i roleve dhe të kompetencave të partnerëve nacional dhe zhvillim të bashkëpunimit	28
	VI.6. Krijimi i sistemit funksional të informacioneve dhe bazë e të dhënave në sferën e arsimit	29
	VI.7. Sigurimi i cilësisë dhe kontrollit të cilësisë së arsimit fillor të të rriturve	30
	VI.8. Masa aktive, stimuluese	30
	VI.9. Zhvillimi i sistemit të “këshillimit për zhvillim” të dedikuar për të rriturit – në kuadër të institucioneve arsimore	30
	VI.10. Promovimi i mundësive të sistemit të reformuar të arsimit fillor të të rriturve dhe afrimi ndaj shfrytëzuesve përfundimtar	31
	VI.11. Modeli modular të arsimit të të rriturve	31
	VI.12. Financimi i arsimit fillor të të rriturve	32
	VI.13. Harmonizimi i rregullativës ligjore	32
VII	Indikatorë për arritje të qëllimeve të paraparë me Konceptimin	33
VIII	Mundësi dhe dobësi potenciale (kërcënime) për realizim të modelit të arsimit fillor të të rriturve	34
	VIII.1. Mundësi	34
	VIII.2. Dobësi potenciale (kërcënime)	35
	VIII.2.1. Rekomandime për parandalim të shkaqeve për mos-kompletim të arsimit fillor	35
	Shtojcë	37

**KONCEPCIONI PËR ARSIM FILLOR TË TË
RRITURVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Arsimi paraqet një nga instrumentet më të fuqishme që mund ta ndryshojë botën. Arsimi nuk paraqet vetëm përgatitje për jetën, por e paraqet vetë jetën. Arritjet arsimore dhe kompetencat e forcës punëtore në dispozicion ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi rritjen ekonomike, potencialin dhe konkurrencën e ekonomive lokale dhe gjasave të Maqedonisë për anëtarësim në Unionin Evropian. Në të njëjtën kohë, ky është edhe një nga faktorët vendimmarrës i cili mund të kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së jetës të popullatës së gjithëmbarshe .

Prioritet kyç i Qendrës për arsimin e të rriturve dhe të Ministrisë për arsim dhe shkencë është krijimi i numrit më të madh dhe kushte më të mira për arsim dhe promovim të mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës. Ky dokument, Koncepti për arsim fillor për të rritur, jo vetëm që e definon nevojën dhe arsyeshmërinë për përgatitjen e saj, por paraqet edhe prezantim të qëllimeve dhe të parimeve të vendit i cili fokusohet në zhvillimin e sistemit bashkëkohor dhe arsimit me cilësi të lartë (formal dhe jo-formal) nga aspekti i qasshmërisë, efikasitetit dhe shtrirjes. I njëjti bazohet në analizën e detajuar të politikave dhe të praktikave në UE dhe rajon, si dhe gjetje nga analiza e politikave relevante nacionale dhe ndërkombëtare, si dhe të gjetjeve nga analiza e dokumenteve, strukturës dhe kushtet nacionale, e janë në kontekst të arsimit fillor të të rriturve .

Koncepti i thekson parasupozimet themelore për avancimin e arsimit fillor të të rriturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ofron projekt model për realizim, përfshirë edhe masat, mekanizmat dhe aktivitetet e nevojshme për përpilim të programeve për arsimin fillor të të rriturve të bazuara në kompetencat kyçe, vendosje të sistemit të vlerësimit të diturisë së fituar paraprakisht dhe ngjashëm. Përveç kësaj, Koncepti jep pasqyrë të shkurtër të kapaciteteve dhe resurseve të nevojshme për zbatimin e qëllimeve të vendosura, i definon rolin dhe përgjegjësitë të partnerëve nacional, duke e theksuar nevojën e krijimit të sistemit funksional dhe bazë të të dhënave, me çka do përmirësohet dhe do të garantohet cilësia e arsimit të të rriturve.

Duke mos e minimizuar kompleksitetin e asaj që qëndron për të në të ardhshme, Koncepti e thekson nevojën për zhvillimin e sistemit për “këshillimit për zhvillim” të dedikuar për të rriturit, në kuadër të institucioneve arsimore, si dhe promovim të mundësive të sistemit të reformuar të arsimit fillor të të rriturve, me qëllim të përafrimit deri te shfrytëzuesit përfundimtar. Koncepti, gjithashtu u bën vështrim edhe dobësive dhe sfidave potenciale për realizim të modelit të arsimit fillor të të rriturve dhe jep rekomandime të caktuara për parandalimin e shkaqeve për mos-kompletimin e arsimit fillor.

Koncepti i arsimit fillor të të rriturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut është prodhim i bashkëpunimit shumëvjeçar dhe i përkrahjes që e gëzon Qendra e arsimit të të rriturve nga Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP). Në përgatitjen e këtij dokumenti kontribut profesional ka dhënë edhe profesor Dr Ognen Spasovski, i cili për shumë vite ka punuar në fushën e përmirësimit të sistemit arsimor. Dokumenti ofron analiza dhe rekomandime të shumta të bazuara në përvoja praktike nga UE dhe rajoni, të cilat do të shfrytëzohen gjatë përcaktimit të prioriteteve të ardhshme, gjë e cila duhet të kontribuojë për sigurimin e përkrahjes më të mirë të përpjekjeve gjatë realizimit të potencialeve të njerëzve, sepse ardhmëria është e përcaktuar në drejtimin në të cilin fillon arsimi.

Lindita Qazimi
Drejtor
Qendra për Arsimin e të rriturve

I. HYRJE

E drejta e të mësuarit është një nga të drejtat themelore të njeriut¹. Procesi i të mësuarit zhvillohet çdo ditë, gjatë tërë jetës, në formë të organizuar ose rastësisht. Përfitimi i diturive dhe të shkathtësive të reja i përgatit edhe individët edhe shoqërinë për zhvillim të ambientit jetësor i cili vazhdimisht ndryshon. Arsimi cilësor mundëson përfshirje kompetente të pjesëtarëve të bashkësisë në jetën shoqërore. Në të njëjtën kohë, arsimi jo-cilësor është faktor i përjashtimit social dhe i regresionit ekonomik.

Shoqëria e Maqedonisë së Veriut mund të jetë konkurruese vetëm nëse bëhet shoqëri e cila mëson, krijon dhe aplikon dituri. Parakusht për atë është të përqafohet dhe zhvillohet koncepti i të mësuarit deri në fund të jetës, përkatësisht gjatë tërë jetës. Ky koncept nënkupton arsim efikas të të rriturve në të gjitha nivelet. Të mësuarit dhe arsimi gjatë tërë jetës kontribuon për qasje më të lehtë në informacionet, në të drejtat dhe shërbimet publike. Në atë mënyrë kontribuon për fleksibilitet dhe shkallë më të lartë të punësimit për të gjitha shtresat e popullatës, dhe me atë edhe për inkluzion më efikas social.

Prapëseprapë, sipas të dhënave zyrtare nga Enti shtetëror i statistikës nga regjistrimi i fundit të realizuar në vitin 2002, afro 18% nga popullata në R. e Maqedonisë së Veriut në moshën prej 15 vjet e më lartë, janë analfabet ose nuk e ka të kryer arsimin fillor². Të dhënat janë edhe më brengosëse nëse dihet se vetëm një pjesë e vogël e këtyre njerëzve janë të kështur në procesin e kompletimit të arsimimit^{3,4}.

Këto të dhëna fitojnë në peshë kur dihet se në Agjencinë për punësim të R. së Maqedonisë së Veriut, personat me arsim fillor dhe me arsim të pa kompletuar fillor e zënë përqindjen më të madhe në numrin e tërësishëm të personave të papunë.

Një pjesë e madhe e popullatës së aftë për punë në Republikën e Maqedonisë së Veriut që është pa arsim fillor në esencë do të mund dhe do të duhej të jetë kontribuues e për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik. Këta persona nuk mund ti shijojnë përfitimet të cilat i sjell arsimi dhe nuk mundën në mënyrë kompetente dhe efikase të kështur në jetën shoqërore dhe në tregun e punës. Shikuar në mënyrë afatgjate, mos-arsimimi krijon mos-arsimim. Mos-arsimimi, më shpesh shpjen drejt varfërisë, ndërsa varfëria prodhon varfëri. Pa masa efikase sistemore, kjo dukuri zhvillohet në spirale vetë-përtëritëse të regresionit që shkon te poshtë edhe në nivel të shoqërisë edhe në nivel individual. Gjendjet e këtilla e theksojnë nevojën për zhvillim të konceptit përkatës për të mësuarin deri në fund të jetës dhe arsim fillor cilësor, efikas për të rriturit.

¹ Deklarata e përgjithshme për të drejtat e njeriut, KB, 1948.

² EShS, regjistrim i popullatës, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë, 2002.

³ EShS, Shkolla fillore dhe të mesme në fillim të vitit mësimor 2010/11, 2011/12, 2012/2013.

⁴ EShS, Shkolla fillore dhe të mesme në fillim të vitit mësimor 2010/11, 2011/12, 2012/2013.

II. NEVOJA DHE ARSYESHMËRIA PËR KONCEPTIM TË RI PËR ARSIMIN FILLOR TË TË RRIURVE NË R. E MAQEDONISË SË VERIUT

Nevoja për koncept të ri për arsimin fillor të të rriturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut buron nga mos-gatishmëria e pjesës të madhe të popullatës në mënyrë kompetente të përfshihet në rrjedhat e shoqërisë bashkëkohore. Një numër tejet i madh i të rriturve kanë nivel jashtëzakonisht të ulët të arsimit gjë e cila i bën jo-konkurrues në tregun e punës ku janë të nevojshëm kompetenca konkrete dhe funksionale. Pamundësia për tu realizuar potencialet vetanake dhe në mënyrë kompetente të merret pjesë në rrjedhat shoqërore, në fund rezultojnë me cilësi të ulët të jetës së shumë individëve, varfëri të thelluar dhe gjendje në të cilën shoqëria nuk ka kapacitet për zhvillim socio-ekonomik. Nga kjo rezultojnë, në pikëpamje të arsimit të të rriturve, nevojat e shoqërisë së Maqedonisë së Veriut përputhen me rekomandimet e institucioneve të BE. Përputhja përbëhet në atë që dokumentet strategjike të BE e theksojnë mundësinë për tu avancuar programet për arsim fillor të të rriturve, programe të cilat do të jenë relevante për zhvillim të kompetencave kyçe për jetën e përditshme dhe për të mësuarin gjatë tërë jetës. Kjo do të thotë se programet duhet të jenë të bazuara në rezultatet dalëse ose rezultatet nga të mësuarit të cilat do tu mundësojnë të rriturve të mund të klyçen në mënyrë kompetente në proceset shoqërore.

Në periudhën e kaluar, faktorët relevant nga institucionet arsimore dhe qarqet akademike krijuan disa dokumente të cilat drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë e trajtojnë arsimin fillor të të rriturve në R. e Maqedonisë së Veriut. Ato dokumente janë krijuar në kushte konkrete dhe në mënyrë e cila është konsideruar se më mirë do tu përgjigjet kërkesave aktuale.

Të dhënat zyrtare për gjendjet aktuale në shtetin tonë tregojnë se është më e madhe përqindja e të rriturve të cilët nuk e kanë të kompletuar arsimin fillor. Prapëseprapë, është shumë i vogël numri i të rriturve të cilët e vazhdojnë shkollimin dhe e kryejnë arsimin fillor.

Në të vërtetë, sipas regjistrimit të fundit në R. e Maqedonisë së Veriut në vitin 2002⁵, nga popullata e përgjithshme në moshën nga 15 dhe më tepër vjet, e cila ka qenë 1596267, pa shkollim kanë qenë 67358 persona, ndërsa me arsim të pakompletuar fillor 219.507. Ajo do të thotë se pothuajse treqind mijë ose gjithsej 18% nga popullata në moshën mbi 15 vjeçare ka qenë pa arsim të kompletuar fillor. Në mënyrë shtesë, brengos shkalla e dallimeve seksuale në këto të dhëna. Sipas të njëjtit raport, nga popullata e përgjithshme në R. e Maqedonisë së Veriut, në moshën nga 10 ose më tepër vjet analfabetë kanë qenë 14993 meshkuj dhe 48569 gra. Edhe te popullata nga 15 vjet dhe më tepër, numri i grave të cilat nuk kanë arsim fillor të kompletuar është pothuajse dyfish më i madh nga numri i burrave në të njëjtën kategori. Në përgjithësi, për shkak të pengesave tradicionale dhe kulturore, gratë shumë më pak e realizojnë këtë të drejtë themelore.

⁵ EShS, regjistrim i popullatës, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë, 2002.

Pa marrë parasysh që regjistrimi është realizuar para më shumë se 12 vjet, nuk ka tregues të cilët vënë në pah se gjendja është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme në periudhën e kaluar, përkatësisht, edhe sot qindra mijë të rritur në shtetin janë analfabet ose pa arsim të plotë fillor. Në këtë në mënyrë të tërthortë udhëzojnë të dhënat nga Enti shtetëror të statistikës. Sipas të dhënave zyrtare nga ky institucion për *arsimim të të rriturve*, në fillim të vitit shkollor 2010/11, në 33 paralele në 12 shkolla, janë regjistruar gjithsej vetëm 365 pjesëmarrës, nga të cilët 119 kanë qenë gra. Në fillim të vitit shkollor 2011/12, në 31 paralele në 11 shkolla kanë qenë të regjistruar gjithsej 390 pjesëmarrës nga të cilët 149 gra⁶. Në fillim të vitit shkollor 2012/13 në 11 shkolla në 32 paralele, kanë qenë të regjistruar gjithsej 379 pjesëmarrës nga të cilët 149 gra, ndërsa në fillim të 2013/14 në 10 shkolla në 33 paralele, kanë qenë të regjistruar gjithsej 314 pjesëmarrës nga të cilët 115 gra. Sipas të dhënave për fundin e të njëjtave vite shkollore, në fund të vitit shkollor 2009/10, arsimin fillor për të rritur e kanë kryer 184 pjesëmarrës. Në fund të 2010/11 gjithsej 227; në fund të 2011/12 arsimin fillor për të rritur e kanë kryer 193, ndërsa në fund të 2012/13 gjithsej 158 pjesëmarrës⁷.

Këto të dhëna vënë në pah se një numër shumë i vogël i të rriturve janë të kyçur aktualisht në procesin e kompletimit të arsimin e vet fillor. Në mungesë të informacioneve nga regjistrimi për periudhën e viteve 2009-2014 për ilustrim mund të bëhet krahasim aproksimativ⁸ të. Krahasimi i tillë ilustron se nga të gjithë të rriturit me arsim të pakompletuar fillor, në procesin e arsimit fillor për të rritur do të mund të pritej se janë të përfshirë vetëm rreth 0,1%, ndërsa çdo vit e kryejnë vetëm për rreth 0,07%.

Të ndryshme janë shkaqet të cilat e sjellin gjendjen e tillë të pavolitshme, për të cilat është jashtëzakonisht e rëndësishme të kihen parasysh gjatë zhvillimit të qasjes së re ndaj arsimit fillor të të rriturve. Për shkak të ndikesës së madhe, theksohen disa shkaqe:

Shumë të rritur nuk e kanë kryer arsimin fillor për shkak të pengesave të ndërlikuara të natyrës ekonomike, socio-kulturologjike, gjuhësore ose për shkak të pengesave intelektuale ose fizike.

Arsimi fillor i të rriturve nuk është në mënyrë të mjaftueshme i qasshëm, atraktiv dhe relevant për pjesën më të madhe të atyre të cilët nuk e kanë atë të kompletuar. Arsimi fillor i të rriturve aktualisht realizohet vetëm në pjesë të vogël të shkollave fillore. Ai në përgjithësi realizohet vetëm përmes provimeve në disa sesione, me çka nuk u është mundësuar që ti përfitojnë dituritë dhe shkathtësitë e nevojshme për përfundimin e shkollimit.

Gjendjet e pavolitshme në masë të caktuar kanë të bëjnë me harmonizimin dhe bashkëpunimin e pamjaftueshëm midis institucioneve dhe trupave, ministrive, Këshillit për arsim të të rriturve, komunitetit lokal.

Gjetjet vënë në pah se planet dhe programet ekzistuese të dedikuara për arsimin fillor të të rriturve nuk mund tu përgjigjen kërkesave dhe nevojave të të rriturve dhe nevojave të shoqërisë. Kjo padyshim e imponon arsyen për të krijuar konceptim të ri për arsimin fillor të të rriturve.

⁶ EShS, Shkolla fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor 2010/11, 2011/12, 2012/2013.

⁷ EShS, Shkolla fillore dhe të mesme në fund të vitit shkollor 2009/10, 2010/11, 2011/12, 2012/2013.

⁸ Të dhënat për numrin e personave të cilët janë regjistruar ose të cilët e kanë kryer arsimin fillor në periudhën 2009/2014 krahasohet me numrin e burrave dhe grave mbi moshën 15 vjeçare sipas regjistrimit të vitit 2002.

Duhet të kihet parasysh se edhe numri i personave të cilët nuk e kryejnë arsimin fillor, në masë të madhe ka të bëjë edhe me dispozitat në Ligjin për arsim fillor, të cilat reflektohen në mënyrë jo të volitshme në pikëpamje të kësaj dukurie. Në të vërtetë, fëmijët të cilët deri në moshën 10 vjeçare nuk janë të regjistruar në arsimin fillor nuk mund ta realizojnë këtë të drejtë në shkollimin e rregullt. Nga ana tjetër, kyçja në arsimin për të rritur është e mundur me 15 vjet të plota. Ato më shpesh janë fëmijë nga grupet e lëndueshme. Në jetën reale, ky disproporcion në legjislativin lë shumë persona jashtë nga kornizat arsimore për një periudhë më të gjatë, periudhë në të cilën ata kurrë nuk kthehen në shkollë.

Gjatë viteve të kaluara janë aplikuar më tepër ligje, risi dhe masa në sferën e arsimit, por *arsimi fillor i të rriturve* kurrë nuk ka qenë në fokusin e reformave.

Në Raportin Nacional për Zhvillimin e arsimit të parashtruar në UNESCO nga Qeveria e R. së Maqedonisë së Veriut në vitin 2008⁹, është konstatuar se në shtetin “nuk ka sistem për arsimin e të rriturve; kultura e të mësuarit është humbur te njerëzit; nuk ka koordinim dhe bashkëpunim midis partnerëve; e varfër është qasshmëria dhe dukshmëria e ofertës arsimore; oferta arsimore është jo-përkatëse për nevojat e popullatës dhe shoqërisë; cilësia e serviseve arsimore është jo-konzistente e kështu me radhë “.

Konceptim i ri në qasjen në arsimin e të rriturve i harmonizuar me sistemet dhe rekomandimet nga institucionet e UE është i nevojshëm edhe për proceset paraqasëse të shtetit në integrimet euro-atlantike. Mu për këtë nevojitet që të zhvillohet sistem i kompetencave të cilat do të jenë kompatible me Kornizën Evropiane të kualifikimeve.

Konceptimi përkatës i arsimit fillor të të rriturve shikuar në mënyrë afatgjate mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme të kontribuojë për tu zhvilluar barazia sociale dhe drejtësia, kohezioni social dhe qytetaria aktive.

⁹ Government of the Republic of Macedonia, Ministry of Education and Science, (2008), Development and State of the Adult Learning and Education: National Report (faq. 4).

III. QËLLIME DHE PARIME TË ARSIMIT FILLOR TË TË RRIURVE NË R. E MAQEDONISË SË VERIUT

III.1. QËLLIME TË KONCEPTIMIT ARSIMI FILLOR I TË RRIURVE NË R. E MAQEDONISË SË VERIUT

Sistem funksional i arsimit fillor i të rriturve ka për qëllim të arrihet:

- përmirësim i cilësisë së arsimit të të rriturve,
- rritje e numrit të të rriturve në proceset e të mësuarit gjatë tërë jetës,
- mundësim i mobilitetit ndaj arsimit profesional dhe të mesëm,
- sigurimi i kushteve për inkluzion kompetent të të rriturve në jetën shoqërore dhe posaçërisht në tregun e punës.

III.2. PARIME TË ARSIMIT FILLOR TË TË RRIURVE NË R. E MAQEDONISË SË VERIUT

Arsimi fillor i të rriturve duhet të bazohet në parimet vijuese:

- **respektimi i të drejtës për mësim dhe arsim:** në pajtim me *Deklaratën e përgjithshme për të drejtat e njeriut të KB*, kjo është një nga të drejtat themelore të njeriut. Arsimi fillor patjetër duhet tu jetë e qasshme të gjithëve dhe duhet të jetë falas;
- **të mësuarit gjatë tërë jetës:** arsimi i të rriturve duhet të jetë e konceptuar në pajtim me nevojat për të mësuar dhe zhvillimin gjatë vazhdës së tërë jetës;
- **relevancë:** proceset e mbindërtimit të të mësuarit dhe të mësuarit të burojnë nga nevojat dhe kërkesat edhe të individit dhe të shoqërisë. Njëkohësisht, ato duhet të mbështeten në gjetjet bashkëkohore për të mësuarit e të rriturve nga sfera e shkencave andragogjike, psikologjike dhe arsimore. Ky është arsimim i cili siguron qytetari aktive;
- **orientim ndaj rezultateve nga mësimi dhe aplikimi i diturive dhe shkathtësive:** arsimimi i të rriturve duhet të jetë i konceptuar në mënyrë që rezultatet dalëse do të jenë në funksion të situatave reale jetësore, të aplikueshme në arsimin e mëtejshëm dhe në tregun e punës;
- **inkluzivitet dhe mundësi të njëjta:** sistemi i arsimit fillor të të rriturve duhet të jetë i konceptuar në mënyrën e cila do të mundësojë përfshirje të të gjithë të rriturve, pa marrë parasysh moshën e tyre, seksin, pengesën në

zhvillim, racën, përkatësinë etnike, religjiozitetin, orientimin seksual ose karakteristikat socio-ekonomike dhe kulturore. Vëmendje e posaçme duhet ti kushtohet sigurimit të mundësive të barabarta për qasje në arsimin fillor për të rriturit për pjesëtarët e grupeve të cenueshme: persona me pengesa, persona nga kushtet e deprivuara socio-ekonomike jetësore, grupe, persona në entet ndëshkuese-përmirësuese e të tjera;

- **arritshmëri:** arsimi fillor duhet të jetë i arritshëm lehtë për të rriturit, me ç'rast, mendohet për në arritshmëri nga aspektet e ndryshme. Para së gjithash, nga aspekti i afërsisë fizike dhe kapaciteteve hapësinore, mandej nga aspekti i afrimit i arsimit ndaj të rriturve të cilët kanë barriera ndaj kyçjes në procesin për shkaqe psiko – sociale, si dhe nga aspekti financiar;
- **njohja dhe dallimi i kompetencave të arritura:** e drejta për evaluim dhe njohje sociale të arritjeve arsimore pa marrë parasysh nëse janë fituar në mënyrë formale, joformale ose informate të të mësuarit (si e drejtë fundamentale të njihet ajo që posedohet);
- **cilësi dhe profesionalizëm:** arsimi fillor për të rritur nënkupton zhvillim të mekanizmave për sigurim të standardeve të profesionalizmit dhe cilësisë në aktivitetet arsimore;
- **fleksibilitet dhe mobilitet:** sistemi i arsimit fillor për të rriturit duhet të jetë e konceptuar në mënyrë e cila do të mundësojë kalueshmëri horizontale dhe vertikale të pjesëmarrësve nëpër nënsistemet dhe nivelet e ndryshme arsimore;
- **qëndrueshmëri:** sistemi i arsimit fillor për të rriturit duhet të jetë i konceptuar në mënyrë e cila do të mundësojë stabilitet dhe qëndrueshmëri në kuptimin financiar, kadrovik dhe programor.

Në qasjet afirmative të arsimit për të rritur, si forma të të mësuarit merren parasysh të gjitha format në të cilat të rriturit mund të mësojnë dhe të përfitojnë dituri dhe shkathtësi, në esencë në mënyrë formale, joformale ose informale.

Në Ligjin për arsim të të rriturve në R. e Maqedonisë së Veriut¹⁰, janë përfshirë mësimi formal dhe joformal. Ato në Ligjin janë të definuara në mënyrën vijuese (Neni 3):

“*Arsimi formal të të rriturve* paraqet veprimtari e cila realizohet në pajtim me ligjet të cilat e rregullojnë veprimtarinë arsim fillor, i mesëm dhe i lartë. Arsimi formal i të rriturve është arsimim i institucionalizuar që zbatohet në ente dhe institucione shtetërore dhe private si arsim i rregullt dhe i ç'rregullt, sipas planeve dhe programeve përkatëse mësimore.

Arsimi joformal i të rriturve paraqet procese të mësimi të orientuara për aftësim të të rriturve për punë, për aktivitete të ndryshme sociale ose zhvillim personal”.

Në Memorandumin për të mësuarin deri në fund të jetës të Unionit Evropian, janë përfshirë të tri format e të mësuarit të të rriturve, ndërsa ato janë të definuara në mënyrën vijuese:

¹⁰ Gaz. Zyrtare e R. së Maqedonisë, nr. 7/08

Arsimi/mësimi formal është ajo që zhvillohet në kuadër të institucioneve të ndryshme arsimore dhe përmes të cilit përfitohen diploma dhe kualifikime të verifikuara.

Arsimi/mësimi joformal është ajo që zhvillohet pavarësisht nga sistemi zyrtar arsimor dhe zakonisht nuk shpjen¹¹ drejt përfitimit të vërtetimeve të konfirmuara. Ky arsim mund të organizohet në vendin e punës dhe përmes aktiviteteve të shoqërive dhe shoqatave të ndryshme. Arsimi i tillë mund të fitohet, gjithashtu, edhe përmes organizatave dhe shërbi-meve të cilat shërbejnë i sistemit formal të arsimit, siç janë shkollat muzikore, klubet sportive, trajnimet private dhe ngj.

Arsimi/mësimi informal definohet si dukuri natyrore në jetën e përditshme; për dallim nga arsimi formal dhe joformal, mësimi informal nuk është e domosdoshme të zhvillohet në mënyrë të vetëdijshme për shkak se edhe individët edhe vetë nuk e dallojnë si faktor i cili kontribuon për rritje të diturive dhe shkathtësive të tyre¹².

¹¹ Në dokumente të ndryshme definicionet dallojnë në pikëpamje të asaj nëse arsimi joformal shpjen ose nuk shpjen drejt përfitimit të vërtetimit, gjë e cila në kontekstin tonë gjuhësor dhe arsimor është ekuivalente me dëftesën.

¹² Komisioni Evropian: Memorandum për të mësuarin deri në fund të jetës, Bruksel, 2000

IV. ANALIZA E POLITIKAVE DHE TË PRAKTIKAVE NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE

IV.1. PASQYRË E POLITIKAVE DHE TË PRAKTIKAVE NË UNIONIN EVROPIAN PËR AVANCI M TË ARSIMIT FILLOR TË TË RRI TURVE

Arsimi fillor i të rriturve në bashkësinë ndërkombëtare është e njohur si e drejtë themelore e ndërlidhur me të drejtën e të mësuarit deri në fund të jetës, por edhe si kontributor i rëndësishëm i zhvillimit shoqëror. Për këtë shkak arsimin fillor për të rriturit e *garantojnë* deklarata dhe konventa të shumta ndërkombëtare, të cilat më tej janë shndërruara në legjislativet e vendeve anëtare.

Ndoshta dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar mbi të cilin viteve të fundit ndërtohen strategjitë të vendeve anëtare të UE për të mësuarin deri në fund të jetës i titulluar si: “Rekomandime të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës për kompetenca kyçe për të mësuarit deri në fund të jetës (2006/962/EC)¹³”. Në këtë dokument, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Evropës u rekomandojnë të gjitha vendeve anëtare të zhvillojnë qasshmëri në *kompetencat kyçe* për të gjithë qytetarët, si pjesë e strategjive të veta për të mësuarin deri në fund të jetës. Bëhet thirrje që të shfrytëzohet *koncepti për kompetenca kyçe* (dhe dokumenti) nga korniza referuese evropiane, me ç’rast rekomandohet që të sigurohen kushtet vijuese:

- arsim fillestar dhe aftësim për tu mundësuar të gjithë të rinjve zhvillim të kompetencave kyçe të cilat do ti përgatisin për jetë,
- arsim përkatës të atyre të cilët për shkaqe të ndryshme kanë nevojë për ndihmë shtesë në mësimin,
- të rriturit të kenë mundësi ti zhvillojnë kompetencat e veta kyçe gjatë tërë jetës, posaçërisht ato të cilat janë të targetuara si grupe prioritare,
- të jetë e vendosur infrastrukturë përkatëse dhe sistem i vazhdimit cilësor të arsimit të të rriturve, dhe përkrahja e tyre për hyrje në tregun e punës.

Në *Rekomandimet* janë theksuar kompetencat kyçe të cilat bëhen kornizë referuese në dokumentet strategjike të vendeve ANËTARE. Ato kompetenca bazike kyçe janë:

1. Komunikim në gjuhën amtare (të parë),
2. Komunikimi në gjuhë të huaj,
3. Kompetencë matematikore dhe kompetenca themelore nga shkencat natyrore dhe teknologjia,

¹³ Official Bulletin of the European Union, (2006), Recommendations of the European Parliament and Council of Europe on the Key Competencies for Lifelong Learning.

4. Kompetencë digjitale,
5. Kompetencë – të mësohet se si të mësohet,
6. Kompetencë sociale/shoqërore dhe civile,
7. Iniciativë dhe sipërmarrësi,
8. Vetëdijesim dhe shprehje kulturologjike.

Parim kryesor në përcaktimin e kompetencave është që ato të jenë relevante për individin dhe për funksionimin e tij kompetent në shoqërinë dhe në tregun e punës. Me këtë rast, definimi i kompetencave në mënyrë të nevojshme nuk i përcjell programet arsimore për arsimin e rregullt fillor dhe të mesëm (të dedikuara për fëmijë në moshën përkatëse). Angazhimi kyç në këtë dokument është që tu lejohet njerëzve avancim i shpejtë (dhe relevant) nëpërmjet arsimit formal ashtu që do tu jetë e mundur ta fitojnë maksimumin nga të mësuarin e tyre joformal dhe informale. Theksohet se njohja e arsimit joformal dhe informale mund ta avancojë statusin e njëjtë dhe barazinë midis njerëzve në tre mënyra konkrete: (1) atyre që shumë herët e kanë braktisur shkollimin (dropouts) u mundëson të kthehen në arsimin formal; (2) ajo mund të jetë atraktive për personat nga grupet e cënueshme; (3) mundëson rebalancim në barazinë midis gjeneratave¹⁴.

Në dokument tjetër të rëndësishëm “Strategji e përtërirë (agjendë) e UE për të mësuarin e të rriturve” theksohet se për arritjen e qëllimeve të “Strategjisë Evropiane për rritje të mençur, të qëndrueshme dhe inkluzive: Evropa 2020”, janë të nevojshme masa për rritje të arsimit në përgjithësi, arsimimit matematikor si dhe format e tjera të përfitimit të diturive dhe të shkathësive, si parasupozime të rëndësishme për marrje të kualifikimeve shtesë për punë dhe pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore. Strategjia përcakton pesë prioritetet për arsimin e të rriturve në Evropën 2020:

1. të mësuarit teri në fund të jetës dhe mobiliteti të bëhet realitet,
2. përmirësim i cilësisë dhe efikasitetit të sistemit të arsimit të të rriturve,
3. nxitje e barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive përmes arsimit të të rriturve,
4. përforsim i kreativitetit dhe inovacionit të të rriturve dhe kushteve të tyre për mësim,
5. përmirësim i bazave të diturive për arsim të të rriturve dhe mbikëqyrje i implementimit të arsimit të të rriturve.

Në kuadër të prioritetit të parë: për tu bërë mësimi deri në fund të jetës dhe realiteti mobil, rekomandohet që të vendoset sistem funksional i vlerësimit të arsimit dhe mësimi joformal dhe informal.

Në pajtim me natyrën dhe rëndësinë e dokumenteve dhe institucioneve të cilat i lëshojnë, këto rekomandime janë të shndërruara në legjislativet e vendeve anëtare dhe dokumentet e tyre strategjike të cilat e rregullojnë çështjen e mësimi deri në fund të jetës, përfshirë edhe arsimin fillor e të rriturve.

¹⁴ OECD,(2010).Recognizing Non-Formal and Informal Learning: Outcomes, Policies and Practices

Në linjë të njëjtë janë edhe analizat e OECD¹⁵. Gjetjet tregojnë se njerëzit të cilët nuk arrijnë ta kryejnë arsimin fillor, më vonë shumë më vështirë kthehen në procesin arsimor. Nga kjo, rekomandohen si të nevojshme programet për të a.q. “shans të dytë”. Me këtë nocion nënkuptohen programe për trajnim për shkrim-lexim, arsim fillor dhe të mesëm, arsim profesional dhe programe të bazuara në shkathtësi punuese, si dhe programe për të dalluar dhe njohur mësimin (arsimin) informale. Në vazhdim, janë sjellë disa shembuj nga vendet anëtare të OECD:

Në Francë të gjitha nivelet e kualifikimeve mund të përfitohen përmes të ashtuquajturin proces të “validizimit të përvojave paraprake” (*la validation des acquis del'experience*). Si shembull, në vitin 2005, 21379 persona janë kyçur në këtë proces, nga të cilët 88% e kanë kryer me sukses.

Në Norvegji të rriturit kanë të drejtë që kompetencat e tyre të përfituara përmes mësimi joformal dhe informale të vlerësohen, si dhe të kenë trajnim të mëtejshëm të shkurtuar të bazuar në përvojën/diturinë e tyre paraprake. Rreth 10.000 të rritur i vlerësojnë çdo vit kompetencat e veta.

Në Portugali sistemi nacional për njohje, validizim dhe certifikim të kompetencave i targeton të rriturit aktiv të cilët kanë nivel të ulët të shkathtësive, dhe mundëson njohje të diturisë së fituar parapraakisht. Qëllimi i sistemit është që tu ndihmojë të rriturve me nivel të ulët të shkathtësive ti përmirësojnë kompetencat e veta të nevojshme për punësim. Ata inkurajohen të kthehen në procesin e arsimit dhe të trajnimit në cilën do qoftë kohë. Në periudhën të viteve 2001-2003, 12.707 persona e kanë validizuar kompetencat e veta.

Në SHBA sistemi i “Zhvillimit të përgjithshëm arsimor” (General Educational Development - GED) parashikon kontrollim në sferat e shkrimit, leximit, njohjeve nga shkencat shoqërore dhe natyrore dhe të matematikës. Këto teste janë të bazuara në normat (standardet) parapraakisht të definuara. Personat të cilat me sukses do ti kalojnë të pesë testet e fitojnë vërtetimin përkatës (GED credential), i cili shërben si ekuivalent i shkollimit të kryer të mesëm. Çdo vit GED e kalojnë midis 400.000 dhe 700.000 banorë të SHBA.

Modele të qasjes së suksesshme sistimore ndaj arsimit të të rriturve

Modelet të cilat perceptohen si të suksesshme dhe si përmirësim i gjendjes ekzistuese, zakonisht dallohen sipas asaj që: ose në mënyrë sistimore aplikojnë mekanizma dhe instrumente efikase të procesit arsimor, ose aplikojnë reforma të suksesshme të mënyrës së realizimit të praktikës arsimore në nivel lokal ose shtetëror. Shikuar nëpër këtë prizëm, si modele veçanërisht të suksesshme të qasjes sistimore ndaj avancimit të të rriturve, shpesh ndahen tre shembuj: modelet në Norvegji, Irlandë dhe Austri. Të gjithë këto modelet janë të ndryshëm, por janë të ofruar si një tërësi sepse çdo njëri prej tyre shquhet si zgjidhje sistimore në domenin konkret. Mu për këtë, modeli irlandez paraqet reformë e suksesshme në nivel të tërë shtetit. Nga ana tjetër, modeli austriak paraqet reformë e suksesshme e implementuar në nivel lokal. Më në fund, modeli norvegjez dallohet për atë që ofron zgjidhje të dobishme dhe efektive për instrument me të cilin arsimi fillor i të rriturve mund të realizohet në mënyrë të harmonizuar me kërkesat e jetës bashkëkohore, ndërsa ajo të jetë e bazuar në rezultatet dalëse të dëshiruara edhe për qytetarët edhe për shoqërinë.

¹⁵ OECD, (2007). No More Failures: Ten Steps to Equity in Education

Norvegjia

Modeli norvegjez si shembull për praktikë të mirë, është i bazuar në konceptin për kompetenca themelore ose kyçe. Modelin e implementon Agjencia norvegjeze për mësimin gjatë tërë jetës VOX, dhe emërtohet “Basic Skills Model”. Në këtë model janë definuar katër kompetenca themelore: për lexim dhe shkrim, komunikim foljor, shkrim-lexim numerik dhe shkrim-lexim digjital. Janë të definuara edhe rezultate konkrete të të mësuarit në jetën e përditshme, arsimin dhe punën (në katër nivele).

Irlanda

Modeli i Irlandës është shembull për praktikë të mirë të reformës institucionale të sistemit të arsimit të të rriturve të zbatuar në nivel shtetëror. Reforma ka filluar me formimin një institucioni qendror (Further Educational Training Authority SOLAS) i cili mundëson politikë kohezive të arsimit të të rriturve, menaxhim të thjeshtë dhe efikas, si dhe kontroll të cilësisë.

Austri

Shembull për praktikë të mirë për zhvillim të programeve për arsim të të rriturve në nivel lokal është modeli austriak, i emërtuar “rajone që mësojnë”. Programet janë të përshtatura për nevojat lokale, por në pajtim me qëllimet strategjike të UE – gjë e cila mundëson financimi të jetë nga fondet evropiane.

IV.2. PASQYRË E POLITIKAVE DHE TË PRAKTIKAVE NË RAJONIN

Qëllimet, parimet dhe përcaktimet kryesore nga dokumentet ndërkombëtare të përshkruara më lartë në masë të madhe janë të përfshira edhe në legjislativet në shumicën e vendeve në rajonin. Për tu nxitur zhvillim i vazhdueshëm i resurseve njerëzore dhe kyçe kompetente e të gjithë individëve në jetën shoqërore dhe në tregun e punës, si qëllim strategjik vendoset kyçe intensive dhe efikase e të të rriturve në procesin e të mësuarit.

Slovenia

Qendra Andragogjike e Sllovenisë¹⁶ ka kompetenca në sferat e hulumtimit, zhvillimit, arsimit, këshillimit, informimit dhe veprimtarive promovuese në fushën e arsimit të të rriturve. Ai në realitet funksionon si *qendër për arsim të të rriturve*, e cila në kompetencat dhe detyrat e veta e ka edhe njohjen (validizimin) e diturive të diturive të fituara në mënyra të ndryshme, si dhe trajnimin e profesionistëve të cilët punojnë në këtë sferë.

Me Ligjin për kualifikime Nacionale profesionale (ekuivalenti sloven të Kornizës Nacionale të kualifikimeve) nga viti 2000, edhe me Ligjin për arsim të të rriturve nga viti 1996, është e mundur lidhja midis arsimit formal dhe joformal, si dhe njohje e arritjeve nga të mësuarit formal dhe informal. Sistemi përkatës i verifikimit të diturisë paraprkishtë të përfituar është i përpunuar në *modelin për zhvillim të kompetencave kyçe* të Sllovenisë, të përgatitur nga Qendra Andragogjike në vitin 2013. Me këtë model, pjesëmarrësit kanë mundësi ta dëshmojnë diturinë e vet përmes provimeve, por edhe përmes formave të tjera të evaluimit.

Ilustrimi për ndërlidhjen midis arsimit formal dhe joformal është ajo që standardet (ajo që është arritur) nga programet për arsimin e të rriturve në vendin e punës njihen si ekuivalente me programet nga arsimi fillor dhe i mesëm. Të rriturit mund ti verifikojnë ato standarde gjatë hyrjes në arsimin formal në nivel të arsimit fillor dhe të mesëm.

Kroacia

Në sistemin arsimor të Kroacisë, Këshilli për arsim të të rriturve ka kompetenca të ngjashme si ato të Qendrës për arsim të të rriturve në R. e Maqedonisë së Veriut . Për përkrahje të punës së Këshillit, është themeluar Agjencia e cila është e ngarkuar në mënyrë strikte për administrimin e të gjitha aktiviteteve që burojnë nga puna e tij.

Seksioni për arsim profesional dhe arsim të të rriturve pranë ministrisë kroate të arsimit në periudhën 2012-2014 realizon projekt nën titullin: “Implementimi i agjendës Evropiane për arsim të të rriturve”, si pjesë e programit për të mësuarin deri në fund të jetës. Me projektin promovohet përfitimi i kompetencave kyçe për të mësuarin deri në fund të jetës, me theks në personat me kualifikim të ulët. Ky projekt duhet të rezultojë me zhvillim të *modelit për arsim fillor të të rriturve të bazuar në kompetencat kyçe*. Modeli është i bazuar në katër kompetenca: (1) komunikim në gjuhë amtare (të parë), (2) kompetencë matematikore dhe kompetenca themelore nga shkencat natyrore dhe teknologjia, (3) kompetenca digjitale, (4) të mësohet se si të mësohet.

Në Strategjinë për arsim të të rriturve janë inkuorporuar rekomandimet nga UE, me ç’rast është theksuar se ndryshimet e shpejta në tregun e punës, plakja e popullatës dhe konkurrenca e vënë në pah nevojën për shfrytëzim të të gjitha diturive dhe shkathtësive, pa marrë parasysh ku dhe si janë fituar. Me vlerësimin e mësimi joformal dhe informale hapen mundësi të reja që individët të marrin vërtetim për kompetencat e veta, me çka do të bëhen kompetent në tregun e punës.

¹⁶ SlovenianInstituteForAdultEducation - AndragoškicenterRepublikeSlovenije, i themeluar në vitin 1992 nga Qeveria e Republikës së Sllovenisë.

Përpyekjet e para për validizim të mësimit joformal dhe informale të përfituar paraprakisht është e rregulluar me Ligjin për arsim të të rriturve, ku është paraparë se “të rriturit mund ta dëshmojnë diturinë dhe shkathtësitë e tyre pa marrë parasysh mënyrën në të cilën janë përfituar”. Në Strategjinë theksohet nevoja për ndryshim të pikëpamjes kulturologjike të arsimit joformal dhe informale. Theksohet edhe fakti se me njohjen e të mësuarit joformal dhe informale shkurtrohet koha e nevojshme për arsim të të rriturve dhe me këtë arrihen kursime të rëndësishme financiare.

Bosnjë e Hercegovina

Dokumentet kyç mbi të cilat bazohet arsimit i të rriturve në B e H janë *Projekt ligji për arsim të të rriturve në Federatën e Bosnjë e Hercegovinës*¹⁷. Sipas Ligjit, arsimimi i të rriturve mund të zhvillohet përmes arsimit formal, arsimit joformal, arsimit informale dhe mësimit të vetë-orientuar. Arsimit fillor në B e H ka të bëjë me persona të cilët nuk e kanë të kompletuar këtë shkallë të arsimit.

Realizimi i programeve për përfitimin e arsimit fillor për të rritur zgjat nga tre muaj për pjesëmarrësit nga klasa e parë deri të pestën, për klasën e gjashtë dhe të shtatë zgjat gjithsej gjashtë muaj, ndërsa për klasën e tetë dhe të nëntë zgjat nga gjashtë muaj.

Pjesëmarrësve të programeve për arsim fillor për të rritur pas përfundimit të klasës së nëntë u jepet dëftesë.

Sipas nenit 40 të të njëjtit Ligj, të rriturit mund ti dëshmojnë dituritë e veta, shkathtësitë dhe aftësitë, pavarësisht nga mënyra në të cilën janë përfituar, me dhënien e provimeve. Me këtë rast, kompetencat e akumuluar përmes arsimit joformal dhe të mësuarit informal duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë si kompetenca të përfituar përmes arsimit formal. Provimet i organizon dhe i zbaton enti i akredituar i arsimit të të rriturve e cila edhe e zbaton programin.

Serbia

Ligji për arsimin e të rriturve në Serbi mundëson që të rriturit ta kompletojnë arsimin e vet në të gjitha nivelet. Me Ligjin përshkruhet edhe mundësia për validizim, ose njohje të arsimit dhe mësimit të përfituar paraprakisht. Me të njëjtin ligj është themeluar edhe Qendra për kualifikime, e cila i përpilon standardet për njohje, si dhe standardet për kualifikime profesionale, akreditim të provajderëve, monitorim dhe evaluim të provajderëve e kështu me radhë.

Në Serbi realizohet programi i quajtur “Shansi i dytë”, i cili mundëson përfshirje, përkatësisht kthyerje të të rriturve në proceset e arsimit.

Kosova

Ligji për arsim të të rriturve në Kosovë gjithashtu parashikon mundësi që të rriturit ta kompletojnë arsimin e vet për të gjitha nivelet. Njëkohësisht, ligji mundëson edhe njohje të mësimit paraprakisht të përfituar formal, joformal dhe informal.

¹⁷ <http://mon.ks.gov.ba/sites/mon.ks.gov.ba/files/Nacr%20Zakona%20o%20obrazovanju%20odraslih.doc>

Shqipëria

Sipas legjislativit ligjor të Shqipërisë, arsimit fillor i të rriturve është i mundësuar për persona që i kanë mbushur 17 vjet, të cilët nuk e kanë të kompletuar këtë shkallë të arsimit¹⁸.

Njëkohësisht, periudha deri në mbushjen e moshës 17 vjeçe është e rregulluar në atë mënyrë që fëmijëve u është mundësuar programi i ashtuquajtur “shansi i dytë”, i cili është në realizimi të ministrisë kompetente për arsimin. Me programin, fëmijët janë kthyer në shkollën, me atë dallim që vijojnë program të shkurtuar sa i përket kohëzgjatjes. Përcaktimi i nivelit të arsimimit të fëmijës, si pikënisje për kyçje në programin, bazohet në nënshtrimin në provim. Provimi në esencë ka funksion të “të dalluarit dhe njohjes” së diturisë paraprakisht të përfituar.

Zgjidhja e këtillë është posaçërisht e dobishme nga aspekti zhvillimor-psikologjik dhe pedagogjik. Në fakt, periudha në të cilën fëmijët me arsim të pakompletuar trajtohen me masa arsimore të parapara për fëmijë është prolonguar me arsye deri në moshën 17 vjeçare në momentin e kryerjes. Në atë mënyrë parandalohet largimi i tyre nga arsimi.

Sipas aktit nënligjor “Udhëzime për organizim të mësimin nga programi “Shansi i dytë”, në kushte të caktuara kur për shkak të vështirësive specifike ose kufizimeve, vijimi i rregullt i shkollës është i pamundësuar, është paraparë mundësia që mësimi të organizohet në familje të caktuara, ndërkaq të realizohet nga një arsimtar. Në atë familje organizohet mësim për më tepër familje në gjendje të ngjashme. Ky mekanizëm emërtohet “ambient arsimor”. Për këta fëmijë bëhet program i individualizuar.

Me përfundimin e programit “shansi i dytë”, pjesëmarrësit marrin dëftesë.

IV.3. ANALIZË E DOKUMENTEVE TË VENDIT, STRUKTURËS DHE GJENDJEVE NË KONTEKST TË ARSIMIT FILLOR TË TË RRI TURVE

IV.3.1. Analizë e legjislativit të vendit dhe të dokumenteve relevante për arsimin fillor të të rriturve

Qëllimet afat-shkurtra dhe afatgjata janë të formuluar në disa dokumente strategjike. Qëllimet janë në harmoni me rekomandimet e trupave të UE dhe përpjekjeve të vendeve anëtare, pa marrë parasysh se duhet pasur parasysh se ato zakonisht janë me formulime më të përgjithësuara. Ato janë të orientuara drejt mundësimin të kushteve për arsimim të të gjithëve, përfshirje të të gjithëve në sistemin arsimor, modernizimin e arsimit për tu mundësuar gatishmëria e qytetarëve për përfshirje aktive në jetën sociale dhe tregun e punës.

Shumica e dokumenteve e rregullojnë ose e prekin në mënyrë thelbësore arsimin fillor të të rriturve, por ato duhet të harmonizohen.

¹⁸ Udhëzim Nr. 29/2013 për procedurat e ndjekjes së arsimit fillor me kohë të pjesshme. Marrë nga: www.mash.gov.al

Një nga dokumentet kryesore strategjike është Programi nacional për zhvillim të arsimit 2005-2015, i miratuar nga Ministria e arsimit dhe e shkencës. Në atë, çështja e arsimit të të rriturve është përpunuar shkurtimisht, me ç'rast kërkohet angazhim i fokusuar në pikëpamje të arsimit fillor të të rriturve.

Arsimi fillor i të rriturve është materie e cila kryesisht është e rregulluar me Ligjin për arsimin fillor, si dhe Ligjin për arsimin e të rriturve nga viti 2008. Arsimi fillor është i garantuar me Kushtetutën e R. të Maqedonisë së Veriut dhe është falas për të gjithë qytetarët. Njëkohësisht dokument jashtëzakonisht relevant është edhe Ligji për Kornizën nacionale të kualifikimeve¹⁹.

Miratimi i Ligjit për arsim të të rriturve nga viti 2008 midis tjerash është me qëllim tu ndihmohet në zgjidhjen e problemit me papunësinë dhe të shërbejë si iniciues të zhvillimit individual, shoqëror dhe ekonomik. Me këtë Ligj themelohet edhe Qendra për arsimin e të rriturve.

Krahas dispozitave ligjore, dokumente kryesore të cilat i trajtojnë arsimin fillor janë *Strategjia nacionale për arsimin e të rriturve*. Njëkohësisht, dokumente relevante janë edhe *Koncepcioni për arsimin nëntëvjeçar fillor* dhe *Raporti për avancimin në pikëpamje të qëllimeve zhvillimore Milenare*.

Pasqyrimi i detajuar i Ligjit për arsim fillor dhe Ligjit për arsim të të rriturve pa shmangie sjell në konkluzën se në to, arsimi fillor trajtohet vetëm në mënyrë periferike. Ligji për arsimin e të rriturve kryesisht është i fokusuar në arsimin profesional, para së gjithash, në arsimin e mesëm profesional dhe arsimin joformal për shkathtësi. Arsimi fillor i të rriturve, përveç dispozitave më themelore, nuk rregullohet në mënyrë më të detajuar.

Programi nacional për zhvillim të arsimit 2005-2015, midis sferave kyçe të intervenimit i përfshin zhvillimin e mundësive arsimore për të gjithë, ngritje e nivelit arsimor të popullatës, por edhe me ndërlidhjen e arsimit formal, joformal dhe informal. Potencohet se: "Lidhjet me mësimin formal dhe joformal rriten në mënyrë permanente. Duhet të respektohet fakti se njerëzit, krahas arsimit formal dhe të organizuar, mësojnë edhe në vendin e punës, në shtëpi, përmes hobeve të tyre dhe aktiviteteve vullnetare e ngjashëm. Përforcimi i kësaj lidhjeje kontribuon për avancimin e aftësive për menaxhim të jetës vetanak, rritjes intelektuale dhe mirëqenies. Sistemi formal arsimor do të zhvillohet në atë mënyrë që do të sigurohet mirëkuptim më i madh për arsimin informal".

Në *Strategjinë për arsimin e të rriturve* jepet pasqyrë e gjendjeve në sferën e arsimit të të rriturve, me ç'rast, si qëllime strategjike janë dalluar:

1. Përforcimi i sistemit të arsimit të të rriturve përmes zhvillimit të sistemit informatik-statik për përcjellje të mobilitetit arsimor të të rriturve;
2. Krijimi i kushteve që të mësoarit deri në fund të jetës dhe mobiliteti të bëhet realitet;
3. Përmirësimi i cilësisë dhe të efikasitetit të arsimit dhe trajnimit të të rriturve;

¹⁹ Gaz. Zyrtare e R. të Maqedonisë, nr. 137/13

4. Promovimi i barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive;
5. Promovimi i arsimit të të rriturve dhe kulturës së të mësuarit përmes qasjes aktive dhe trajnimit të të rriturve.

Koncepcioni për arsimin nëntëvjeçar fillor është i fokusuar në arsimin e rregullt fillor, dhe për këtë shkak, arsimi fillor i të rriturve përmendet vetëm në një paragraf – si mundësi për nxënësit në shkollën fillore të cilët nuk do ta kryejnë me sukses arsimin fillor nëntëvjeçar në afatin e paraparë (në faq. 85).

Raporti për avancimin në pikëpamje të qëllimeve zhvillimore Milenare nuk e trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë arsimin fillor të të rriturve. Por, vetë definicioni i një nga tetë qëllimet zhvillimore “arritje e arsimit universal, gjithëpërfshirës fillor”, në mënyrë të tërthortë rëndësinë e tij.

Në *Strategjinë për zvogëlim të varfërisë dhe të përjashtimit social 2010-2020*²⁰ është theksuar se punësimi i ulët është posaçërisht karakteristik për ata me arsim më të ulët. Arsimimi i ulët si një faktorët kryesor të cilët ndikojnë mbi aktivitetin e ulët në tregun e punës është theksuar edhe në pikëpamje të popullatës së grave.

Aplikimi i “Kornizës së kualifikimeve të Maqedonisë së Veriut”²¹ është me rëndësi të jashtëzakonshme për rregullimin e niveleve të arsimit dhe sistemin e kualifikimeve në shtetin. Njëkohësisht, ajo mundëson harmonizim me standardet evropiane të kualifikimeve. Me rëndësi të jashtëzakonshme është “Korniza nacionale e kualifikimeve (KNK)”, kalueshmëri dhe cilësi të kualifikimeve (neni 2, alineja 1 nga Ligji). Më tej në alinenë thuhet: “Kornizës së kualifikimeve të Maqedonisë së Veriut (KKMV) është standard i obligueshëm nacional me të cilin rregullohet fitimi dhe shfrytëzimin e kualifikimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe instrument për vendosje të sistemit të kualifikimeve të fituara në Republikën e Maqedonisë së Veriut me të cilat jepen bazat për dukshmëri, qasje, kalueshmëri, fitim dhe cilësi të kualifikimeve.

Në një varg të paragrafëve dhe neneve, mund të shihet se ky dokument i rëndësishëm jep bazë për rregullim të çështjes së kualifikimeve të qytetarëve, të fituara në mënyra të ndryshme. Paragrafët që e japin këtë bazë janë ndarë dhe janë ndërlidhur në vijim:

Në këtë drejtim, në nenin 2 alineja 9 definohe se “Kualifikim” është rezultat formal nga procesi i vlerësimit i cili është fituar kur institucion përgjegjës konfirmon se individi i ka arritur *rezultatet nga mësimi* në pajtim me standardet e përcaktuara Në alinenë 17 definohe se “përshkrime të kualifikimeve” janë tregues të matshëm të *rezultateve nga mësimi* të cilat kanë të bëjnë me dituritë, shkathtësitë dhe kompetencat e përfituara. “Rezultatet nga mësimi” vv alineja 19 definohe si deklarata për atë që dihet, që *kuptohet dhe çka mund të bëjë pjesëmarrësi, si rezultat i procesit formal, joformal dhe informal të të mësuarit*. Ajo që nënkuptohet me nocionin “mësimi informal” është definuar në alinenë 23: në realitet, ai është i mësuarit që buron nga aktivitetet e përditshme jetësore, familje ose në kohën e lirë. Ai nuk është i strukturuar në raport me qëllimet e mësimit, kohën e mësimit ose përkrahjen në mësimin.

Sipas nenit 3: “Parime”, janë parime themelore të KNK janë: sigurimi i kushteve për qasje të barabartë në arsimin

²⁰ Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe MPPS, (2010). *Strategjia nacionale për tejkalim të varfërisë dhe përjashtimit sociale në Republikën e Maqedonisë 2010-2020*.

²¹ Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe MASH. Ligji për kornizë Nacionale për kualifikim. Gaz. Zyrtare e R. të Maqedonisë, nr. 137 e datës 07.10.2013

gjatë tërë jetës për përfitimin dhe njohjen e kualifikimeve (alineja 6), si dhe “ndërtim i sistemit të vlerësimit të të mësuarit joformal dhe informal (alineja 9).

Sipas nenit 4 (“Qëllime të KNK “), KNK ka për qëllim:

- ti definojë qartë rezultatet e të mësuarit,
- të vendos sistem të vlerësimit të kualifikimeve të ndryshme në kornizat e sistemit të tërësishëm të kualifikimeve,
- nxitje dhe zhvillim i të mësuarit gjatë tërë jetës (të mësuarit deri në fund të jetës),
- ti prezantojë lidhjet e qarta midis pjesëve të ndryshme të sistemit arsimor,
- ta vë në pah kalueshmërinë dhe avancimin (horizontal dhe vertikal) përmes dhe në kuadër të të gjitha llojeve të arsimit dhe të trajnimit (formal, joformal dhe informal);

Në nenin 5 përshkruhet se “Korniza e Maqedonisë e kualifikimeve është përshkrim *i obligueshëm unik* që dallohet në suaza ndërkombëtare me të cilin përshkruhen të gjitha kualifikimet e ndërlidhura midis vete dhe rezultate nga mësimi dhe përcaktohen raportet midis kualifikimeve.

Neni 13: Zhvillimi i kualifikimeve” (1) përcakton se *kompetentë* për zhvillimin e kualifikimeve nga niveli I deri V-B janë:

- Qendra për arsim dhe trajnim profesional,
- Qendra për arsimin e të rriturve dhe
- Byroja për zhvillimin e arsimit;

ndërsa në nenin 15, midis organeve, enteve, trupave dhe komisioneve kompetente për zhvillim, kontrollim, miratim, njohje dhe klasifikim të kualifikimeve në Kornizën e Maqedonisë së Veriut , e radhit edhe Qendrën për arsim të të rriturve.

IV.3.2. Analiza e strukturës së institucioneve relevante për arsimim të të rriturve

Në republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë më tepër lloje të institucioneve, të cilat e përbëjnë sistemin e arsimit të të rriturve. Nga njëra anë ato janë institucionet shtetërore dhe publike të cilat kanë kompetenca dhe janë përgjegjëse për arsimin e të rriturve në vendin tonë, ministria kompetente për arsim (MASH), Qendra për arsimin e të rriturve, ministria kompetente e punës (MPPS), Këshilli për arsimin e të rriturve, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe partnerët social. Komptenca të caktuara kanë edhe Inspektorati shtetëror i arsimit, Qendra shtetërore e provimeve, të cilat burojnë nga natyra e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

Në pajtim me nenin 5 nga Ligji për arsimin e të rriturve, këtë veprimtari mund ta bëjnë entet publike dhe private për arsimin e të rriturve, institucione për arsimin e të rriturve, qendrat për përsosje, punëdhënësit dhe partnerët social, shoqatat e qytetarëve dhe trajnuesit individual, të cilët i përmbushin kushtet e përshkruara me këtë ligj.

Nga ofruesit ekzistues të arsimit të të rriturve mund të ndahen:

- institucione të specializuara publike dhe private për arsim të të rriturve: universitete të punëtorëve, firma konsulente arsimore. Qendra për trajnim, qendra për gjuhë të huaja, qendra për arsimim kompjuterik, qendra për punë këshillëdhënëse, shkolla fillore për arsim të të rriturve,
- shkolla të mesme;
- sindikata;
- oda ekonomike dhe asociacione;
- agjenci për punësim;
- trupa profesionale;
- universitete.

Të gjitha këto lloje të institucioneve mund të përfshihen para së gjithash në pikëpamje të trajnimeve dhe kualifikimeve profesionale. Por, kur bëhet fjalë për arsimin *fillor* të të rriturve, ekzistojnë kufizime të caktuara, për shkak të dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me arsimin *formal*.

Këshilli për arsimin e të rriturve sipas nenit 10 nga Ligji për arsim të të rriturve ka kompetenca të propozojë Strategji për arsim të të rriturve dhe Plane aksionare të cilat burojnë nga Strategjia (i miraton MASH). Njëkohësisht Këshillit i është ndarë kompetenca ta përcjell realizimin e planeve aksionare, si dhe të miratojë raportet vjetore për realizimin e planeve aksionare, që i përgatit Qendra për arsimin e të rriturve. Me këto kompetenca, Këshilli ka mekanizma të drejtpërdrejta për kontroll të realizimit të qëllimeve që janë paraparë me dokumentet strategjike për arsimin e të rriturve.

Më tej në të njëjtin nen, Këshillit për arsimin e të rriturve i jepet kompetencë të “propozojë financim të programeve për arsimin e të rriturve për të cilat janë siguruar mjete në buxhetin e R. të Maqedonisë së Veriut”; si dhe, “në bashkëpunim me komunat, ministrisë ti dërgojë propozim për zhvillim të rrjetit të enteve për arsimin e të rriturve”.

Mund të konkludohet se *Këshilli* ka kompetenca me të cilat “nga maja e poshtë” mund të integrohen dhe të koordinohen aktivitetet e nevojshme. Nëse në praktikë *Këshilli* nuk funksionon më mënyrë efikase dhe nuk i zbaton këto kompetenca, pengohen mundësitë për zhvillim të arsimit të të rriturve dhe si ato do të realizohen. Duke pasur parasysh atë që këto aktivitete janë në kompetencë të Këshillit, Këshilli është i perceptuar si trup nga i cili duhet të dalin iniciativat për avancim të gjendjeve në arsimin e të rriturve, si dhe supervizioni i realizimit të tyre. Ajo që Këshilli perceptohet

si përgjegjës për të shtuar cilësi në arsimin e të rriturve, sjell dukurinë që institucionet e tjera relevante të mos “ndjejnë” përgjegjësi të drejtpërdrejtë për gjendjet në këtë sferë. Në gjendje të tillë, nuk mund të priten iniciativa të cilat do të sjellin ndryshime cilësore nga institucionet e tjera.

Ministria e arsimit dhe shkencës

Sipas Ligjit për arsimin e të rriturve, neni 7, alineja 8: MASH është kompetente të:

- miratojë strategji të arsimit të të rriturve dhe plane aksionare vjetore për realizimin e saj, në sajë të propozimeve nga Këshilli për arsimin e të rriturve,
- propozojë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut rrjet të enteve për arsimin e të rriturve,
- jep mendim Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për ndërprerje të punës së enteve për arsimin e të rriturve, në mënyrën e përcaktuar me ligj,
- bëjë verifikim të enteve për arsimin e të rriturve, në mënyrën e përcaktuar me ligj,
- lëshojë verifikim enteve dhe institucioneve për arsimin e të rriturve,
- mbajë regjistër të enteve të verifikuara për arsimin e të rriturve,
- miraton plane dhe programe arsimor nacionale kornizë për arsimin e të rriturve,
- miratojë plan dhe programe arsimore për arsim fillor, të mesëm dhe profesional për të rriturit, me propozimin e Qendrës për arsimin e të rriturve (në tekstin e mëtejme: Qendra),
- sigurojë mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për financimin e të rriturve në sajë të nevojave të shtetit.

Qendra për arsimin e të rriturve

Qëllimet kryesore të Qendrës për arsimin e të rriturve janë të kontribuojë në realizimin e nevojave socio-ekonomike të Maqedonisë së Veriut, tu përgjigjet nevojave të tregut të punës dhe tu ndihmojë individëve në zhvillimin e tyre personal. Si detyra kryesore të Qendrës identifikohen:

- Ti harmonizojë dhe integrojë interesat publike dhe interesat e partnerëve social në arsimin e të rriturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Qendra e koordinon bashkëpunimin me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare në sferën e arsimit të të rriturve; dhe

- Të sigurojë sistem cilësor të arsimit të të rriturve në pajtim me standardet dhe praktikat evropiane përmes vendosjes së standardeve dhe kritereve të cilat do të sigurojnë arsim cilësor formal dhe joformal të të rriturve dhe krijim të fuqisë punuese cilësore dhe konkurruese në tregun e punës me përkrahje të partneritetit social.

Kompetencat e Qendrës për arsimin e të rriturve janë të përcaktuara me Ligjin për arsimin e të rriturve, ndërsa të shndërruara në Statutin. Sipas Statutit, Qendra:

- përgatit plane dhe programe arsimore për arsimin fillor, të gjimnazit dhe profesional të të rriturve, përgatit model për programe të vlefshme publikisht për arsimin e të rriturve;
- kryen përcjellje, analizë dhe zhvillim të sistemit të arsimit të të rriturve;
- punon në avancimin e arsimit dhe trajnimin e të rriturve, në bashkëpunim me entet dhe institucionet për arsim të të rriturve;
- bën hulumtim nga sfera e arsimit të të rriturve;
- bën punë këshillëdhënëse - të mentorizimit të kuadrit i cili i realizon planet për arsim të të rriturve;
- organizon përsosje profesionale dhe trajnim të arsimtarëve dhe të trajnuesve;
- propozon zgjidhje për përmirësimin e lidhjeve midis arsimit formal dhe joformal.

V. PARASUPOZIME THEMELORE TË ARSIMIT FILLOR TË TË RRIURVE NË R. E MAQEDONISË SË VERIUT

Koncepcioni i ri për arsimin fillor të të rriturve duhet ta dallojë të drejtën individuale të mësimit dhe arsimin gjatë tërë jetës, me ç'rast rezultatet dalëse nga mësimi të jenë relevante për individin për përfshirje kompetente në proceset shoqërore, Rezultatet e tilla e të mësuarit do të jenë relevante edhe për zhvillimin e shoqërisë.

Qasja e tillë, në fokusin e koncepcionit të ri i vendos kompetencat kyçe. Ekziston nevoja që të definohet sistem i kompetencave kyçe për arsimin e të rriturve që përkohet me kontekstin në Maqedoninë e Veriut . Institucione relevante arsimore në bashkëpunim me të gjithë faktorët e involuara do të duhet bashkërisht të definojnë standarde të diturive, shkathtësive dhe qëndrimeve të transmetueshme, përkatësisht kompetenca transversale kyçe. Me këtë rast, “Kompetenca kyçe paraqesin shumë e transmetueshme, shumë-funksionale e diturive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nevojshme për çdo person për plotësim dhe zhvillim të tij/saj, aktivizëm qytetar, inkluzion social dhe punësim “, si që definohen në dokumentin e përmendur Rekomandime të Parlamentit dhe Këshillit të BE.

Më tej, në sajë të kompetencave kyçe nevojitet të zhvillohet *program arsimor* i adaptuar në nevojat e të rriturve dhe qëllimeve të arsimin fillor të të rriturve.

Koncepti i kompetencave kyçe nuk e përcjell në mënyrë të nevojshme kurikulën e arsimin të rregullt fillor. Programi i arsimin të rregullt fillor është i krijuar në pajtim me nevojat e nxënësve në moshën fëmijërore dhe ai nuk përkohet me nevojat e personave të rritur. Njëkohësisht, sistemi i kompetencave kyçe inkorporon dituri dhe shkathtësi të cilat pjesëmarrësit mundet tanimë i kanë fituar në mënyrën joformale ose informale të mësimit. Mu për këtë, qasja e tillë nënkupton zhvillim të sistemit të verifikimit të diturisë së përfituar paraprakisht. Për tu mundësuar verifikimi, ka nevojë të definohen *standarde* dhe *nivele* të diturive dhe të shkathtësive, si dhe kritere për *evaluim* të mësimit dhe diturive të fituara paraprakisht.

Edhe pas verifikimit të diturisë paraprakisht të përfituar, gjithësesi në pjesë e konsiderueshme nga të rriturit me arsim të pakompletuar fillor do të kenë nevojë të përfshihen në procesin shtesë të të mësuarit për ta arritur nivelin e kompetencave kyçe të paraparë si përfundimtare. Përkatësisht, kandidatët do të kenë nevojë për trajnim dhe plotësim të mëtejshëm të mësimit si mbindërtim i kompetencave mbi nivelin e vërejtur, me qëllim që ta kryejnë arsimin fillor. Realizimi i këtyre projeksioneve parasuporton resurse përkatëse të realizimit.

VI. PROPOZIM-MODEL PËR ARSIMIN FILLOR TË TË RRIURVE I BAZUAR NË KOMPETENCA KYÇE: MASA, MEKANIZMA DHE AKTIVITETE

Propozim-modeli i ofruar për arsimin fillor të të rriturve është i bazuar në konceptin e kompetencave kyçe. Ai është komplementar me rekomandimet nga dokumentet strategjike të UE, të bazuara në nevojat e qytetarëve për mësimin deri në fund të jetës dhe nevojat e shoqërisë për zhvillim të vazhdueshëm. Mekanizmat e parapara mundësojnë inkluzion arsimor për qytetarët pa marrë parasysh deri në cilin nivel është arsimi i tyre i përfituar. Në fakt, propozim-modeli mundëson kyçe në procesin arsimor për qytetarët të cilët aspak nuk e kanë filluar arsimin fillor ose konsiderojnë se kanë nevojë ta fillojnë nga fillimi. Në të njëjtën kohë, qytetarëve të cilët kanë përfituar dituri të caktuara në mënyrë formale, joformale ose informale, modeli u mundëson verifikim të atyre diturive dhe u mundëson ta vazhdojnë arsimin deri në arritjen e standardeve të parapara për kryerje të arsimit formal fillor.

Njëkohësisht, duke i pasur parasysh reformat aktuale në nivel shtetëror, modeli është i paramenduar që të jetë kompatible edhe me Kornizën nacionale të kualifikimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

VI.1. ZHVILLIM I SISTEMIT TË KUALIFIKIMEVE TË DEFINUARA KYÇE

Hap kyç në zhvillimin modelit të krijimit të sistemit të *kualifikimeve* të definuara *kyçe* i të rriturve në nivel të arsimit fillor. Kuptimi i kompetencave kyçe duhet të bazohet në rezultate dalëse ose rezultate të mësimit. Kompetencat kyçe të kuptuara në këtë mënyrë do tu mundësojë të rriturve që në mënyrë aktive dhe funksionale të kyçen në tregun e punës dhe në përgjithësi në jetën shoqërore.

Në definimin e kompetencave kyçe të cilat do të jenë përkatëse për kontekstin shoqëror dhe arsimor të Maqedonisë, së Veriut duhet të marrin pjesë institucionet relevante arsimore në bashkëpunim me të gjithë faktorët e involvuar. Me këtë rast, në përcaktimin e kompetencave kyçe duhet të kihet parasysh më tepër faktorë që janë specifik për kontekstin tonë:

- numri tejet i madh i të rriturve të cilët nuk kanë arsim të kompletuar fillor,
- nevoja qenësore të të rriturve për përfshirjen e tyre kompetente në proceset shoqërore,
- specifikat e sistemit arsimor të Maqedonisë, struktura, rrjeti i institucioneve, kuadri me të cilin disponohet, shkalla e trajnimit të kuadrit,
- nevojat e shoqërisë së Maqedonisë së Veriut për zhvillim socio-ekonomik, me ç'rast do të mbahet llogari për balansin midis nevo jave të tregut dhe nevojat për zhvillim të shoqërisë “së mirë”,
- përvoja dhe praktika pozitive nga vende të tjera,

- rekomandimet e UE, dhe me qëllim që legjislativi i Maqedonisë v së Veriut dhe praktika në sferën e arsimit dhe kualifikimet të harmonizohen me ato të UE.

Kompetencat e përfituara, në pajtim me Kornizën nacionale të kualifikimeve mund të jenë të kalueshme në kredi. Me atë, sistemi i bazuar në kompetenca kyçe bëhet fleksibil dhe zhvillimor dhe mundëson interaksion edhe në një sistem më të gjerë të kompetencave transversale.

Duke u nisur nga rekomandimet e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës për kompetencat kyçe për mësimin deri në fund të jetës, të cilat përkojnë me kontekstin shoqëroro dhe arsimor të Maqedonisë së Veriut , modeli për arsimin fillor të të rriturve duhet të bazohet në kompetencat vijuese kyçe:

1. Komunikimi në gjuhën e amtare (të parë):

kjo kompetencë ka të bëjë me aftësi për shprehje gojore dhe me shkrim dhe shpjegim të drejtë dhe sipas rregullave të koncepteve, mendimeve, ndjenjave, qëndrimeve dhe fakteve, si dhe interaksion gjuhësor në gjendje të ndryshme sociale: në punë, në procesin arsimor, në jetën e përditshme. Suksesi në të mësuarin e gjuhës te individët do të varrojë në katër dimensionet: të dëgjuarin, të folur, të lexuarin dhe të shkruarin.

2. Komunikimi në gjuhë të huaj:

në masë të madhe i përfshin dimensionet kryesore për komunikim në gjuhë amtare, por gjithashtu nënkupton edhe shkathtësi për kuptimin ndër-kulturor, vokabular dhe gramatikë. Niveli i suksesit në të mësuarin do të varrojë në katër dimensionet: të dëgjuarin, të folur, të lexuarin dhe të shkruarin, e në kontekst të gjuhëve të ndryshme.

3. Kompetenca matematikore dhe kompetenca themelore nga shkencat natyrore dhe teknologjia:

ka të bëjë me aftësimin e individit për zhvillim dhe aplikim të të menduarit matematikor në zgjidhjen e problemeve në jetën e përditshme. Kompetenca natyrore-shkencore ka të bëjë me aftësinë për aplikimin e diturive me të cilat bota e natyrës, për të parashtruar pyetje dhe për të sjellë konkluzë në sajë të fakteve. Kompetenca teknologjike kuptohet si aftësim për aplikim të diturive natyrore-shkencore dhe të metodologjisë si përgjigje për nevojat e njeriut.

4. Kompetencë digjitale:

ka të bëjë me aftësimin për përdorim të sigurt dhe kritik të teknologjisë informatike për punë në jetën personale dhe sociale, si dhe për komunikim.

5. Kompetenca – të mësohet se si të mësohet:

nënkupton aftësi për proces të të mësuarit dhe qëndrueshmërisë në të mësuarin, organizimin e mësimin të vet, përfshirë edhe menaxhimin efikas me kohën dhe informacionet si gjatë të mësuarit vetanë, ashtu edhe gjatë të mësuarin në grup.

6. Iniciativa dhe sipërmarrësi:

ka të bëjë me aftësinë e individit që ti realizojë idetë, ndërsa përfshin krijimtari, iniciativë dhe gatishmëri për marrje të rrezikut, si dhe aftësi për planifikim dhe vijim të planeve për realizimin e qëllimeve.

7. Kompetenca shoqërore dhe civile:

këto kompetenca përfshijnë shkathtësi personale, ndër-njerëzore dhe inter-kulturore dhe i përfshijnë të gjitha format e sjelljes të cilat individët i aftëson për pjesëmarrje, në mënyrë efikase dhe konstruktive, në jetën shoqërore dhe punuese, e posaçërisht në një shoqëri me diverzitete. Këto shkathtësi i aftësojnë individët që në tërësi të marrin pjesë në jetën civile, në sajë të diturive për nocionet dhe strukturat shoqërore dhe politike, si dhe sjellin përkushtim në pjesëmarrje aktive dhe demokratike.

8. Vetëdijesimi dhe shprehja kulturologjike:

ka të bëjë me zhvillim të të shprehurit kreativ të ideve, përvojave dhe emocioneve, përmes medieve të ndryshme, përfshirë edhe arte të performimit, muzikë, letërsi dhe arte vizuale. Ajo përfshin vetëdije për trashëgiminë lokale, nacionale dhe evropiane dhe vendin e tyre në botën. Përfshin njohuri themelore të të mirave kryesore kulturore dhe të kulturës bashkëkohore të popullarizuar.

VI.2. ZHVILLIMI I PROGRAMIT ARSIMOR TË BAZUAR NË KOMPETENCAT KYÇE

Programi arsimor duhet të jetë i bazuar në rezultate dalëse (çka “pjesëmarrësi mund...”, ose çka “pjesëmarrësi bën”) të cilat janë reale dhe relevante për pjesëmarrësit për kyçe të mëtejme në jetën shoqërore dhe në tregun e punës. Ato rezultate dalëse duhet të jenë edhe në funksion të nevojave të shoqërisë për zhvillim të përshpejtuar socio-ekonomik.

Programi duhet të jetë e përpiluar nga institucione dhe faktorë relevant arsimor, sipas standardeve të definuara paraprakisht të bazuara në kompetencat kyçe. Përkatësisht, programi duhet të jetë e përpiluar nga përmbajtje dhe të jetë e konceptuar në mënyrë që të jetë në funksion të përfitimit të kompetencave kyçe transversale.

Në pajtim me Ligjin për Kornizën nacionale të kualifikimeve, programi duhet të jetë i shndërruar në kredi.

VI.3. ZHVILLIMI I SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË DITURISË PARAPRAKISHT TË PËRFITUAR

Propozim-modeli i bazuar në kompetencat kyçe para-supozon vendosje të sistemit të vlerësimit dhe verifikimit të diturive paraprakisht të përfituara. Me sistem të tillë do të dallohen dhe verifikohen kompetencat e fituara paraprakisht përmes arsimit joformal dhe të mësuarit informal. Kjo nevojë është e shënuar në Strategjinë për arsim të të rriturve, si dhe në Ligjin për Kornizën nacionale të kualifikimeve, ndërsa kjo është bërë sipas shembullit Kornizës Evropiane për kualifikime.

Modeli i kompetencave para-supozon standarde paraprakisht të definuara në raport me të cilat do të bëhet verifikimi. Ato standarde kanë të bëjnë me nivelet në të cilat posedohen kompetencat dhe në këtë mënyrë do të vlerësohen. Arritja e të gjitha standardeve të diturive dhe të shkathtësive do të konsiderohej si posedim i kompetencave.

Për verifikim të suksesshëm, nevojitet që kuadri i involvuar të jetë i trajnuar në mënyrë përkatëse për procesin e kontrollimit dhe të verifikimit të kompetencave.

Kryerja e arsimit fillor për të rriturit sipas këtij modeli, në mënyrë të nevojshme duhet të vlerësohet dhe verifikohet me *certifikatë* me vlefshmëri të njëjtë si edhe dëftesa për arsim të kryer të rregullt fillor, me të cilën do të mundësohet kalueshmëria e të rriturve në arsim të mesëm, dhe me të cilën ata do të mund ti realizojnë të gjitha të drejtat të cilat i mundëson dëftesa (si për shembull e drejta për t'ju nënshtruar provimit për patentë shoferi).

VI.3.1. Evaluimi i diturisë dhe kompetencave paraprakisht të përfituara

Procesi i vlerësimit nënkupton ekzistim të instrumentit me të cilin ai do të zbatohet. Evaluimi i diturisë paraprakisht të përfituar duhet të jetë në formë të testimit të diturive dhe të shkathtësive sipas formave paraprakisht të përgatitura të evaluimit, në pajtim me standardet paraprakisht të definuara. Evaluimin do të mund ta bënin vetëm shkollat e ose institucionet shtetërore të akredituara. Vetë evaluimi mund të pasurohet me informacione të ndryshme të qasshme dhe relevante. Instrument i tillë mund të jetë, për shembull, portofoli, për të cilin ka formular të zhvilluar në mënyrë të suksesshme edhe në kontekstin tonë arsimor²². Një portofol i tillë do të ndihmojë që pjesëmarrësi të jetë aktiv në mësimin e tij/të saj, të ketë kontroll në rezultatet e procesit të vet të të mësuarit, të zhvillojë vetëdije për kompetencat e zhvilluara te vetvetja, si dhe ta zhvillojë vetëdijen dhe motivimin për fazat e mëtejme nga procesi i të mësuarit.

Duhet të kihet në mendje se i tërë procesi i vlerësimit dhe evaluimit, definimi i standardeve dhe zhvillimi i programit mësimor, duhet të jetë i bazuar në rezultatet dalëse të të mësuarit. Ideja prijëse duhet të jetë: çka pas procesit të kompletimit të arsimit fillor i rrituri *do të mund të bëjë*.

VI.4. KAPACITETE DHE RESURSE TË NEVOJSHME PËR IMPLEMENTIM TË QËLLIMEVE TË PARAPARA ME KONCEPTIMIN

Për realizim të modelit për arsim fillor të të rriturve, janë të nevojshme resurse përkatëse materiale dhe njerëzore, shumë më vëllimore se ato ekzistueset. Në situatë të dëshiruar për përfshirje masive në arsimin fillor për të rriturit, do të jetë e nevojshëm zgjerim radikal i resurseve hapësinore dhe kadrovike. Në trajnimin dhe të mësuarin e pjesëmarrësve mbi nivelin e kompetencave të konstatuara, do të mund të kyçen lloje të ndryshme të institucioneve, paraprakisht të akredituara për gatishmëri për punë sipas programit të paraparë. Institucionet të cilat kanë potenciale të jenë të përgatitura në mënyrë përkatëse për trajnim të të rriturve që nuk kanë arsim të kompletuar fillor janë: shkolla fillore, shkolla të mesme, universitete

²² Ky është portofoli i shfrytëzuar në Tuining projektin për zhvillim të Shkathtësive themelore: Tuining projekti MK /07/IB/SO/05 "Përkrahje për ndërtimin e kapaciteteve të Qendrës për arsim të të rriturve dhe zhvillim të programeve për arsim të të rriturve dhe programe për të mësuar shkrim-lexim dhe për formësimin e plotë të arsimit fillor të personave të përjashtuar".

punëtore, biznes bashkësia dhe OJQ të cilat punojnë në sferën arsimore. Nëse i përmbushin kriteret, nuk ka bazë që kyçja e këtyre organizatave të hasin në skepticizëm. Në shoqërinë tonë ekziston pluralizim në sferat të cilat nënkuptojnë standarde shumë më të larta të diturive, pikërisht në arsimin e mesëm dhe të lartë. Nga kjo, për këto organizata nuk do të paraqiste kriter të porealizueshëm për tu përgatitur për mësimin e të rriturve për përmbajtje në nivel të arsimit fillor.

Shikuar nga pozita e ngjashme, shkollat e mesme me kompetencë të njëjtë do të mund të kyçeshin në procesin e dhënie së mësimi. Njëkohësisht, konteksti i shkollave të mesme të të rriturit mund të ndikojë në mënyrë stimulative për ta vazhduar arsimin me përsosje profesionale.

Në kontekst të resurseve njerëzore, drejtorët e shkollave do të kenë rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në realizimin e këtyre qëllimeve, si persona të cilët janë lidhja e shkollës me bashkësinë lokale, biznesin dhe OJQ bashkësinë, dhe persona që kompetent në mënyrë të drejtpërdrejtë për përgatitje përkatëse të kuadrit në shkollat.

R. e Maqedonisë së Veriut ka rrjet relativisht mirë të degëzuar në universitetet punëtore, që kanë përvojë shumë dekadëshë në punën me të rritur pa arsim të kompletuar fillor, si dhe kuadër i cili tanimë është i aftësuar për punë me të rritur.

Në këtë kontekst, mund të shfrytëzohen kapacitetet edhe të sektorit civil, duke pasur parasysh atë që shumë organizata joqeveritare kanë interaksion më të drejtpërdrejtë me personat nga grupet e cënueshme, të cilat në masë të madhe e përbëjnë popullatën e të rriturve pa arsim fillor.

Për marrje të akreditimit për realizim të arsimit fillor të të rriturve nevojitet trajnimi i parapare ligjor andragogjik. Njëkohësisht, kuadri në mënyrë të nevojshme duhet të jetë i trajnuar për praktikë inkluzive arsimore, ndërsa me qëllim të sigurohen mundësi të njëjta për qasje në arsimin fillor për pjesëtarët e grupeve të cënueshme.

VI.5. DEFINIMI I ROLEVE DHE KOMPETENCAVE TË PARTNERËVE NACIONAL

Analiza e gjendjeve në shtetin vë në pah bashkëpunimin dhe koordinimin e pamjaftueshëm midis partnerëve të involvuara në procesin arsimor. Me këtë rast mendohet në bashkëpunimin dhe koordinimin në kuadër të vetë institucioneve, midis resorëve relevante, si dhe në pikëpamje të ndërtimit të partneritetit në relacionin: institucione qeveritare, bashkësia lokale, organizata joqeveritare dhe biznes sektori.

Në radhë të Parë, sipas shembullit të modelit austriak “Rajone që mësojnë”, nevojitet që vetëqeverisja lokale të jetë e kyçur në mënyrë aktive në zhvillimin e arsimit në bashkësinë e vet. Ajo duhet të nxis dhe të përgatit plane zhvillimore të bazuara në specifikat dhe nevojat e qytetarëve dhe bashkësisë në tërësi. Projektet për arsim fillor të të rriturve gjithsesi duhet të jenë të përkrahura nga buxheti qendror.

Ekziston arsye që të zhvillohen edhe plane rajonale. Në situatën kur disa komuna nga i njëjti rajon ballafaqohen me vështirësi të njëjta (faktorë të ngjashëm për nivelin e ulët të arsimit të qytetarëve), do të kishte qenë e dobishme të zhvillohen plane rajonale për përkrahje të arsimit të bazuara në specifikat konkrete të atij rajoni. Në atë mënyrë, me përkrahje të Ministrisë dhe institucioneve qeveritare mund të zhvillohet aksion i cili do të kishte qenë shumë më ekonomik në kuptim të planifikimit, mënyrën dhe kohën e realizimit, dhe me atë edhe financiarisht.

Për miratim efikas të politikave arsimore në lidhje me të rriturit dhe zbatimin e tyre, nevojitet shpërndarje e qartë e roleve, detyrave dhe përgjegjësi. Në strukturën aktuale të institucioneve arsimore, roli i *Këshillit për arsim të të rriturve (Këshilli)* është kyç. Ligji për arsim të të rriturve të *Këshillit* si trup intern-resor i ja jep rolin e nxitësit dhe gjeneratorit të proceseve në sferën e arsimit të të rriturve, por në të njëjtën kohë edhe rolin e trupit-supervizues i cili e kontrollon zbatimin e planeve aksionare. Nëse kihet parasysh se tjetër institucion nuk është i deleguar me këto kompetenca, do të duhej të nënkuptohet se *Këshilli* e bart edhe përgjegjësinë për implementimin e politikave. Por, çështja e përgjegjësisë rreth zhvillimit të planeve aksionare dhe realizimit të tyre nuk është e trajtuar në mënyrë të qartë dhe të precize.

Duhet të kihet parasysh se edhe *Këshilli* nuk është institucion operacional. Kjo do të thotë se për zbatimin e politikave dhe qëllimeve të projektuara në planet e veprimit duhet të obligohet dhe institucioni përgjegjës i cili një mandat relevant dhe mekanizma konkrete. Në sistemin tonë arsimor institucion i tillë paraqet *Qendra për arsimin e të rriturve*. Qendra për arsimin e të rriturve duhet të jetë e obliguar për zbatimin e programeve, me çka do të arrihet kërkesa për të ekzistuar kompetencë dhe përgjegjësi e qartë në zbatimin e politikave dhe planeve, si një parakusht thelbësor për zbatimin e tyre efikas. Duke pasur parasysh se fusha e veprimtarisë është mjaft e gjerë, në realizimin, Qendra për arsimin e të rriturve do të mbështeten dhe do të përdor resurset edhe të institucioneve tjera relevante arsimore, e para së gjithash të MASH dhe të BZha.

VI.6. KRIJIMI I SISTEMIT FUNKSIONAL TË INFORMACIONEVE DHE BAZËS SË TË DHËNAVE NË SFERËN E ARSIMIT

Në mënyrë që dokumentet strategjike dhe legjislacioni në nivel shtetëror të planifikohen dhe përgatiten në mënyrë më cilësore, dhe njëkohësisht të bazohen në të dhënat e “forta”, është e nevojshme që të zhvillohet një sistem funksional i informacioneve dhe bazës e të dhënave mbi situatën në fushën e arsimit të të rriturve. Ky sistem duhet të bazohet në grumbullimin e përmirësuar e të dhënave, kërkime dhe analiza të sistemit të arsimit për të rritur, ndërsa domosdoshmërisht do të përfshijë edhe kërkime ndërkombëtare. Në atë mënyrë do të arrihej përmirësim i bazave të themeleve të diturive tona për arsimin e të rriturve dhe monitorimin e veprimtarive në këtë fushë. Në këtë kontekst, me rëndësi të veçantë është përfshirja në disa studime jashtëzakonisht relevante ndërkombëtare, të tilla siç janë: Programi për vlerësimin ndërkombëtar të kompetencës së të rriturve (PIAAC), Hulimtim mbi arsimin e të rriturve (AES), Hulimtim për edukimin e vazhdueshëm profesional (CVTS). Të dhënat e marra nga studimet ndërkombëtare lejojnë krahasimin me sistemet dhe gjendjet në vende të tjera, shfrytëzimin e praktikave të mira dhe përvojat që kanë të bëjnë me ballafaqimin me sfidat. E gjithë kjo është paraqet një bazë shtesë për programimin dhe planifikimin e programeve të zhvillimit.

Ky sistem kompleks i informacioneve do të duhej të jepte një përgjigje të saktë, duke u bazuar në faktet mbi disa çështje: për shkaqet që çojnë që të rriturit të mos e përfundojnë arsimin fillor; ndikimi i përkatësisë gjinore, etnike, fetare për këtë dukuri; çfarë janë gjendjet me personat me aftësi të kufizuara në kontekstin e këtij fenomeni, e të tjera.

Njohuritë e mbledhura në bazë të tillë të dhënash, të fituara nga më tepër burime relevante, do ta mundësojnë krijimin e zgjidhjeve për përmirësimin e gjendjeve, të cilat do të bazohet në gjendjet reale dhe nevojat e shtetit.

VI.7. SIGURIMI I CILËSISË DHE TË KONTROLLIT TË CILËSISË TË ARSIMIT FILLOR TË TË RRITURVE

Në mënyrë që modeli i propozuar ti japë rezultatet e dëshiruara, duhet të sigurohet cilësi dhe kontroll i cilësisë i arsimit fillor për të rritur nga disa aspekte: Programet arsimore të bazuara në kompetencat kryesore duhet të jenë tërësisht dhe me kompetencë të dizajnuara dhe të përgatitura - të cilat më tej do të jenë subjekt i akreditimit; Sistemi i institucioneve në të cilat to të zbatohet procesi arsimor duhet të jetë i zhvilluar në një masë e cila do të kënaq nevojat reale për proces cilësor arsimor të të rriturve në vend; Institucionet e përfshira në këtë proces në mënyrë të nevojshme duhet të kënaqin kritere paraprakisht të definuara për cilësi, të cilat do të rishikohen në mënyrë të vazhdueshme; Personeli i cili do të jetë i përfshirë në këtë proces duhet të jetë i trajnuar me cilësi të lartë dhe të vazhdueshme për zbatimin praktik të njohurive nga fusha e andragogjisë, pedagogjisë dhe psikologjisë së mësimdhënies; Është e nevojshme të zbatohet kontroll i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies në institucionet arsimore; Në mënyrë të vazhdueshme të vlerësohet cilësia e kompetencave të përfituar kyçe përmes kontrollimit të rezultateve të përfituara nga mësimi (ose rezultate dalëse).

VI.8. MASA AKTIVE, STIMULUESE

Në mënyrë që të inkurajohet motivimi i të rriturve për t'u angazhuar në arsimin fillor, duhet të merret në konsideratë aplikimi i masave aktive, të cilat në kushte të caktuara, do mund të jenë në formë të motivimit të kushtëzuar në para. Si ilustrim, në strategjinë e Kroacisë për arsimin e të rriturve parashihet aplikimi i masave të stimulimit financiar për individët dhe punëdhënësit të cilat do ti financonte shteti apo komuniteti lokal. Për të punësuarit ofrohen ditë të lira, të nevojshme për arsimimin e tyre, krijimin i një fondi për arsimin e të rriturve, etj.

Për të rriturit pa arsim fillor të plotë që do të kyçen dhe me sukses do ta përfundojnë arsimin e vet fillor me sukses, është e mundur që të aplikojnë masa të transferit të kushtëzuara në para, përkatësisht, përfituesit e ndihmës sociale në para të marrin një rritje të caktuar të shumës..

Në masat që propozohen, si domosdoshmëri theksohet edhe nevoja për rritje të ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e arsimit si dhe informimi i të rriturve pa arsim të plotë fillor për mundësitë e vazhdimit të arsimimit.

VI.9. ZHVILLIMI I SISTEMIT TË “KËSHILLIMIT PËR ZHVILLIM” TË DEDIKUAR PËR TË RRITURIT

Të gjitha institucionet e akredituara (shkollat, OJQ-të, universitetet punëtore, qendrat për punë sociale MPPS, komunat, etj), do të mund të jenë të trajnuara për të dhënë këshilla për të rriturit për mundësitë ekzistuese për arsimimi të tyre të mëtejme, përkatësisht të funksionojë si një lloj i qendrave joformale të këshillimit. Është e nevojshme të ekzistojë një rrjet i gjerë i informimit, edhe njëkohësisht edhe ndërgjegjësimi të opinionit i gjerë se për informacionet e nevojshme themelore mund ti drejtohen dhe ti marrin në çdo institucion qeveritar apo komunal. Si për shembull, në shkollat atë funksion do ta kishte pasur një shërbim profesional (drejtor, pedagog, psikolog, punëtor social).

Në ueb faqen e Qendrës për arsimin e të rriturve mund të krijohet *portal interaktiv* në funksion të arritjes së qëllimeve. Ata që tashmë kanë kompetenca gjuhësore dhe digjitale, do të mund të shërbehen me këtë portal si resurs për *e-mësim*, prej ku do të mund ti mësojnë përmbajtjet e kërkuara. Në të njëjtën kohë, ai do të mund të përfshijë linqe nga rrjeti i shkollave, OJQ-ve dhe institucioneve të tjera, ku mund të marrin falas informacione, këshillime dhe rrumbullakësim të trajnimit për arritje të standardeve për kompletimin e arsimit fillor, si dhe për zhvillimin e mëtejshëm profesional.

VI.10. PROMOVIM I MUNDËSIVE TË SISTEMIT TË REFORMUAR TË ARSIMIT FILLOR TË TË RRIURVE DHE AFRIMIN TE SHFRYTËZUESIT PËRFUNDIMTAR

Modeli i arsimit fillor për të rriturit për ti arritur qëllimet, duhet të jetë e mundur që pjesëmarrësit potencial të jenë të informuar dhe *ti njohin* si relevant dhe i dobishëm për ta. Në informimin dhe motivimin e të rriturve pa arsim fillor të plotë është e nevojshme që të angazhohen të gjithë partnerët. Qendrat për punë sociale dhe organizatat jo-qeveritare do të kishin pasur një rol tejet të të rëndësishëm dhe të suksesshëm. Ky objektivi parasupozon aktivitetet në kontakt të drejtpërdrejtë me kandidatët, dhe jo rrallë edhe aksion “nga dera në derë”.

Motivimi i ulët është një rrezik faktor serioz. Gjegjësisht, duke pasur parasysh nivelin e ulët të arsimimit dhe të shkrim-leximit, të rriturit pa arsimin të kompletuar fillor shumë vështirë e dallojnë interesin e tyre për tu përfshirë në arsimin. Kjo dukuri në bashkëveprim me barrierat psikologjike të ndërlydhura me përfshirjen në arsimin fillor në moshën madhore, si dhe arsytet ekonomike, i largojnë nga vendim-marrja për të kërkuar informacion dhe të përfshihen në procesin e vazhdimin të arsimimit të vet. Për këtë arsye, nevojitet që arsimiti të afrohet popullatës së targetuara, për t’iu bërë kjo diçka e afërt dhe e njohur, dhe tek ata të zhvillohet nevoja për ta vazhduar dhe kompletuar arsimimin. Prandaj, paraqitet nevoja që mësimi tu afrohet këtyre të rriturve, gjë e cila duhet të përfshijë më shumë lloje të institucioneve. Në procesin e “afërimit” mund të përfshihen “modele” pozitive nga komuniteti më i ngushtë, për tu përgatitur fushata në të cilën do të theksohen përfitimet dhe avantazhet e kështu me radhë.

VI.11. MODELI MODULAR I ARSIMIMIT TË TË RRIURVE

Propozim-modeli mundëson modularitet të arsimit të të rriturve e në kuptimin e moduleve të ndryshme të arsimit në nivel të ndryshëm. Gjegjësisht, këto module mund të jetë: (1) mësimi i shkrim-leximit (2) arsimit fillor dhe (3) arsimit profesional. Për model të këtillë parakushtet themelore në sistemin tonë tashmë ekzistojnë. Në praktikën arsimore, ka programe të analfabetizmit - të cilat do ta përbënin modulën e parë. Modelin e përshkruar në këtë dokument, i cili është ekuivalent me arsimin e rregullt fillor (të definuar sipas Kornizës nacionale të kualifikimeve) – e përfaqëson modulën e dytë. Përvetësimi i shkathësive profesionale, e cila do të mund të mbindërtohet në arsimin fillor - do ta përbënte modulën e tretë. Struktura për të tre modulet në vendin tonë ekziston, ku moduli i parë dhe i tretë tani funksionojnë në kuadër të edukimit joformal.

VI.12. FINANCIMI I ARSIMIT FILLOR TË TË RRIURVE

Në pajtim me të drejtën e garantuar me Kushtetutë për arsim fillor pa pagesë, i tërë programi në mënyrë të nevojshme duhet të jetë falas për të gjithë pjesëmarrësit. Ajo nënkupton mbulim të shpenzimeve reale për të gjithë partnerët e përfshirë në realizimin e tij, në cilën do qoftë fazë apo formë. Njëkohësisht, procedura e regjistrimit dhe vijimit të aktiviteteve të parapara duhet të jetë e përshtatur për njohuritë dhe aftësitë e pjesëmarrësve të mundshëm, sidomos nëse kihet parasysh se ata janë më arsim të ulët dhe nuk kanë aftësi komunikimi me procedurat administrative. Kjo do të thotë se administrata në institucionet relevante arsimore duhet të jetë në shërbim të lehtësimit të procedurave për kandidatët.

Financimi i arsimit fillor i të rriturve në mënyrë të nevojshme duhet të jetë e precizuar. Ligji për Arsimin e të rriturve parashikon që Komuna, Odat ekonomike, Sindikata mund të themelojnë institucione për arsimimin e të rriturve, por duhet vetë duhet ta realizojnë financimin. Edhe pse këto dispozita në mënyrë prioritare kanë të bëjnë me trajnimet profesionale joformale, është e nevojshme të saktësohen procedurat e themelimit dhe financimit të arsimit fillor të të rriturve. Nga praktika e deritanishme mund të shihet se këto subjekte (institucione) nuk tregojnë një interes të madh për financimin e programeve për arsimimin profesional të të rriturve, gjë e cila është edhe më e theksuar kur bëhet fjalë për arsimin fillor të të rriturve. Shkaku i mundshëm është buxheti i kufizuar dhe prioritetet në planifikimin e buxhetit. Nëse interesi prioritar i shtetit është të gjithë (shumica) e të rriturve ta kenë të kompletuar arsimin fillor, është e nevojshme që të merret përgjegjësia për financimin, veçanërisht që mjetet e shpenzuara në raport me rëndësinë e çështjes do të kishin qenë dukshëm më të ulëta.

VI.13. NEVOJA PËR HARMONIZIM TË RREGULLATIVËS LIGJORE

Për të arritur objektivat e projektuara me këtë koncept, nevojitet të bëhen disa harmonizime të rregullativës ligjore. Këto përshtatje kryesisht duhet të drejtohen tek pikat vijuese:

- për tu përfutur role dhe kompetenca qartë të definuara të institucioneve të obliguara për planifikim dhe realizim të arsimit të të rriturve, nevojitet të harmonizohet Ligji për arsimin fillor, Ligji për arsimim të të rriturve, Ligji për Byronë për zhvillim të arsimit, Ligji për arsim profesional;
- ka nevojë të përcaktohen mundësitë për fëmijët që ta kryejnë arsimin fillor deri në moshën 17 vjeçare;
- harmonizim i rregullativës për tejkalim të hendekut midis 10 dhe 15 vjet;
- përmes ligjit të mundësohet kyçje e sektorit civil në të mësuarin e të rriturve;
- saktësim ligjor me të cilin arsimit fillor i të rriturve, në cilën do qoftë institucion: njësitë e vetëqeverisjes lokale, organizatat e sektorit civil, universitetet e punëtorëve duhet të financohet nga buxheti qendror, nga mjetet e dedikuara për realizim të me Kushtetutë të garantuarin arsim fillor pa pagesë për të gjithë qytetarët.

VII. INDIKATORË TË ARRITJES SË QËLLIMEVE TË PARAPARA ME KONCEPTIMIN

Duke pasur parasysh faktin se ky dokument paraqet një koncept ideor për zhvillimin e arsimit fillor për të rriturit, në të nuk mund të përcaktohen indikatorë konkret sasior për arritjen e qëllimeve. Një tjetër faktor që e pengon një gjë të tillë është ajo se aktualisht nuk ka bazë e të dhënave për arsimin e të rriturve, e cila do të shërbente si pikënisje për krahasim me arritjet e ardhshme. Për këtë arsye, si tregues të arritjes së qëllimeve të parapara mund të shërbejnë ndryshimet e projektuara pozitive në aspektin e përfshirjes dhe cilësisë së arsimit të personave të rritur të cilët nuk kanë arsim të kompletuar fillor. Si indikatorë të përgjithshëm mund të shërbejnë informacionet nga disa kategori:

- Shkalla në buxhetin e dedikuar për programet për arsimin fillor të të rriturve,
- Përfshirje e të rriturve në arsimin fillor të të rriturve,
- Shkalla e të rriturve që dinë shkrim-lexim dhe të rriturve me arsim të kryer fillor,
- Rritje e proporcionit të personave të cilët janë të regjistruar dhe që kanë përfunduar arsim fillor për të rritur,
- Norma e rritjes së shkallës të të regjistruarve në arsimin e mesëm,
- Rritje në normën e personave të regjistruar në arsimin joformal, në trajnime profesionale (të cilat si parakusht kërkojnë minimum të arsimit të kryer fillor),
- Rritja e personave me aftësi të kufizuara të cilët janë regjistruar dhe që e kanë përfunduar arsimin fillor për të rritur,
- Zvogëlimi i shkallës së grave pa arsim fillor për të rriturit,
- Rritje e pjesëmarrësve në arsimin fillor të të rriturve në burgjet dhe shtëpitë ndëshkuese dhe korrektuese,
- Ndryshime në shkallën (raportin) meshkuj-femra të cilët janë regjistruar dhe e kanë kryer arsimin e plotë fillor, sipas përkatësisë etnike,
- Numri i shkollave të involvuara në realizimin e arsimit fillor për të rriturit,
- Numri i bashkësive lokale të involvuara në programet zhvillimore për arsimin fillor për të rriturit,
- Numri i OJQ-ve të përfshira në zbatimin e arsimit fillor për të rriturit,
- Numri i subjekteve të biznesit të përfshira në programet zhvillimore për arsimin fillor për të rriturit.

VIII. MUNDËSI DHE DOBËSI (KËRCËNIME) POTENCIALE TË MODELIT TË ARSIMIT FILLOR TË TË RRIURVE

VIII.1. MUNDËSI

Ekzistojnë më tepër anë të fuqishme dhe mundësi për zhvillim të arsimit fillor të të rriturve:

- Anë e fuqishme në të cilën mund të mbështetet zhvillimi i modelit është në atë se në shtet ekziston një rrjet i institucioneve arsimore publike me përvojë shumë dekadëshe në krijimin dhe implementimin e programeve arsimore;
- Anë e fuqishme në të cilën mund të mbështetet mbi zhvillimin e modelit është edhe ajo se në shtetin ekziston një institucion i formuar konkretisht për arsimin e të rriturve (Qendra për arsimin e të rriturve);
- Anë e fuqishme e sistemit arsimor në vend është ajo se ekziston një rrjet i madh i institucioneve dhe kuadër të cilët kanë potencial ta realizojnë arsimin e të rriturve;
- Potencial për zhvillimin e modelit është edhe rrjeti i organizatave joqeveritare dhe të organizatave ndërkombëtare të cilat mund të sigurojnë mbështetje të fuqishme;
- Në zhvillimin e modelit, ekziston mundësi që i tërë procesi të harmonizohet me politikat dhe rekomandimet e BE-së. Kjo në të njëjtën kohë është dhe mundësi për avancim të programeve vendore për zhvillim të kompetencave kyçe në pajtim me Kornizën referuese Evropiane të kompetencave kyçe;
- Fakti që shteti po përballet me një numër të të rriturve pa arsim fillor të plotë mund të paraqet bazë për aplikim në fondet e Bashkimit Evropian, para së gjithash për programet e zhvillimit të arsimit, zhvillimit rural, mbështetje të rajoneve të zhvilluara në mënyrë të pamjaftueshme, zhvillim rajonal e t.j. Zbatimi i programeve të tilla do të kishte qenë në drejtim të realizimit të rekomandimeve të BE-së për zhvillim të vazhdueshëm të qytetarëve të cilët marrin pjesë në programet për arsimimin e të rriturve;
- Përgatitje e modelit është një mundësi që në shtetin të zhvillohet sistem për vlerësim dhe verifikim të diturisë së fituar paraprakisht, si nevojë e cila është me rëndësi qenësore për zhvillimin individual dhe shoqëror;
- Duke pasur parasysh atë që periudha për të cilën janë planifikuar më tepër dokumente strategjike në shtetin kalon shpejt²³, ajo është mundësi që krijimi i dokumenteve të reja të harmonizohet me qëllimet e sistemit arsimor të vendit, ndërsa e harmonizuar edhe me rekomandimet e BE.
- Zhvillimi i modelit të ri paraqet mundësi për krijimin e kushteve të avancuara përmirësuar për akreditim të enteve për arsim të të rriturve.

²³ Siç janë: Programi nacional për zhvillimin e arsimit 2005-2015 dhe Strategjia për zhvillim të arsimit të të rriturve.

VIII.2. DOBËSI DHE KËRCËNIME POTENCIALE

Zhvillimi i arsimit fillor të të rriturve në vend përballat edhe me më shumë dobësi dhe kërcënime të mundshme. Për tu shmangur efektet eventuale negative, vëmendje duhet tu kushtohet këtyre dukurive:

- Ka dallime të mëdha mes komunave dhe rajoneve të ndryshme në aspektin e numrit të të rriturve pa arsim fillor të kompletuar. Në të njëjtën kohë, të mëdha janë dallimet të mëdha midis rajoneve dhe komunave në aspektin e numrit të institucioneve që do të mund të ofronin arsim për të rriturit, gjë e cila do të reflektohej në qasshmërinë e arsimit për kandidatët;
- Përkundër shkallës solide të përgatitjes të arsimtarëve për lëndët, ata nuk janë të përgatitur në shkallë të mjaftueshme për të mësuar të rriturit dhe nuk kompetencë të plotë për praktikë inkluzive arsimore. Kjo paraqet sfida serioze për arritje të arsimit cilësor dhe të rezultateve nga mësimi;
- Nëse arsimimi fillor i të rriturve nuk ngritët në nivel të prioritetit në shtetin, financimi i kësaj sfere mund të rrezikohet. Rezultati i tillë si pasojë do ta rrezikojë realizimin e qëllimeve të projektuara;
- Zhvillimi i modelit dhe zbatimin i qëllimeve mund të rrezikohen nëse nuk krijohet bashkëpunim cilësor dhe thelbësor midis institucioneve arsimore në shtet me kompetencë dhe përgjegjësi të dhënë në mënyrë të qartë;
- Mos-ekzistimi i bazës cilësore të të dhënave për gjendjet në arsimin mund të jetë kërcënim për planifikimin cilësor të programeve zhvillimore;
- Kërcënim potencial është masiviteti i operacionit i cili duhet të kryhet, për shkak të numrit të madh të rriturve pa arsim fillor të plotë. Masiviteti i aksionit ndoshta fsheh shumë momente që mund ta rrezikojnë realizimin e suksesshëm. Prandaj, ka nevojë për përgatitje të plotë dhe të paramenduar të çdo hapi dhe pilotimi i obligueshëm i programit;
- Zhvillimi i modelit të kompetencave kyçe mund të kërcënohet nëse bartësit e politikave janë të fokusuar vetëm në nevojat e tregut të punës, me ç'rast do të lihej anësh zhvillimi i kompetencave transversale dhe të programeve me interes më të gjerë për komunitetin;
- Si një kërcënim për tërë sistemin arsimor mund të shihet mundësia e rritjes së largimit të shtuar nga arsimi i rregullt fillor, në qoftë se modeli i ri perceptohet si më atraktiv. Në këtë gjendje hipotetike patjetër duhet të shihet ndaras nga realizimi i modelit për arsim fillor të të rriturve të bazuar në kompetencat kyçe. Me këtë sfida sistemi patjetër duhet të ballafaqohet me masa përkatëse për arsimin e rregullt fillor, masa të adaptuara për moshën e fëmijëve të përfshirë në procesin. Ato janë masa për parandalim të shkaqeve për mos-kompletimin e arsimit fillor.

VIII.2.1. *Parandalim i shkaqeve për mos-kompletim të arsimit fillor*

Sipas analizave të OECD, ata që nuk arrijnë ta kryejnë arsimin fillor, më vonë shumë më vështirë kthehen në procesin e shkollimit. Për tu zvogëluar numri dhe proporcioni i të rriturve që nuk e kanë përfunduar arsimin fillor, nevojitet të vepohet me masa të fuqishme të parandalimit të shkaqeve të cilat e kanë sjellë rezultatin e tillë. Masat për parandalimin e shkaqeve për mos-kompletimin e arsimit fillor duhet të jenë të konceptuara rreth dy proceseve të ndërlidhura: (1) të mundësohet inkluzion efikas dhe efektiv arsimor²⁴ të të gjithë nxënësve, gjë e cila e thekson nevojën për përpjekje më të mëdha të orientuara ndaj nxënësve nga grupet e cenueshme, (2) ballafaqimi me mësimin e parregullt dhe pakësimin e nxënësve në arsimin e rregullt.

Sistemi i arsimit fillor në të cilin ka pakësim të lartë dhe braktisje të hershme është jofunksional dhe i kushtueshëm, sepse mundëson gjenerimin të një numri të madh të të rriturve të ardhshëm pa kompetenca themelore. Prandaj, masë strategjike është ballafaqimi me rreziqet më të mëdha për braktisjen, si dhe pjesëmarrjen e parregullt të arsimit fillor e cila më vonë bëhet arsye për largim nga shkolla. Shumë nxënës, e posaçërisht ato nga grupet e cenueshme janë veçanërisht thyeshme ndaj periudhave transitorë midis mësimin klasor dhe me lëndë, si dhe midis arsimit fillor dhe të mesëm. Për këtë shkak, është e theksuar nevoja për masa dhe trajnim të posaçëm të arsimtarëve dhe shërbimit për tu ballafaquar me sfidat në praktikën arsimore.

²⁴ Me inkluzion arsimor nënkuptojmë arsimim në të cilin janë përfshirë të gjithë fëmijët, dhe të gjithë fëmijët kanë mundësi të barabarta që ti zhvillojnë të gjitha potencialet e veta.

DREJTME TË IMPLEMENTIMIT

Me pjesëmarrje të të gjitha institucioneve relevante për arsimin dhe në bashkëpunim me të gjithë faktorët e prekur ka nevojë të ndërmerren aktivitetet vijuese për implementim të konceptit të arsimit fillor për të rriturit në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

1.	Të zhvillohet sistem i <i>kompetencave</i> të definuara <i>kyçe</i> për të rriturit në nivel të arsimit fillor, që përkojnë me kontekstin e Maqedonisë.
2.	Të zhvillohet program i bazuar në kompetencat kyçe. Ai duhet të jetë i bazuar në rezultate dalëse të cilat janë reale dhe relevante për pjesëmarrësit për kyçe të mëtejme në jetën shoqërore dhe tregun e punës.
3.	Në pajtim me programin, të përgatiten vendosje didaktike metodike të arsimit fillor të rriturve dhe mënyrat për realizim të mësimin dhe të operacionalizohen modulet.
4.	Duke u nisur nga programi, ka nevojë të definohen <i>standarde</i> dhe <i>nivele</i> të diturive dhe të shkathtësive.
5.	Të përpilohen kritere për <i>evaluim</i> të diturive dhe shkathtësive të përfituara paraprakisht në mënyrë formale, joformale dhe informale.
6.	Të zhvillohet sistem i mekanizmave dhe instrumenteve për verifikim të diturisë paraprakisht të përfituar.
7.	Të përcaktohen nevojat në komuna dhe rajone të ndryshme, si bazë për strategjinë e implementimit.
8.	Të përcaktohen resurset e nevojshme materiale dhe njerëzore për realizim të modelit për arsim fillor të të rriturve dhe të definohen rolet e partnerëve nacional.
9.	Të zhvillohet sistem i kriterëve për akreditim të institucioneve dhe organizatave të cilat do të mund të kyçen në procesin e arsimit fillor të të rriturve. Ai duhet të përcillet me zhvillim të sistemit të kontrollit të cilësisë së arsimit.
10.	Të zhvillohet sistem i kriterëve për akreditim të shkollave dhe institucioneve shtetërore të cilat do të kishin qenë përgjegjëse për verifikim të diturive dhe të shkathtësive (përfshirë edhe diturinë paraprakisht të përfituar përmes arsimit joformal dhe mësimin informal).
11.	Të harmonizohet dhe përmirësohet dispozitat ligjore të cilat janë konfliktuoze, ose të cilat lënë mundësi që persona të caktuar të mos jenë të kyçur në mënyrë efektive në arsimin.
12.	Të zhvillohet sistem funksional i informacioneve dhe bazë e të dhënave për gjendjet në sferën e arsimit të të rriturve, përfshirë edhe realizimin e studimeve hulumtuese.
13.	Të përgatitet modeli i certifikimit të arsimit fillor të të rriturve.
14.	Të përpilohet model inkluziv të financimit, në pajtim me normat kushtetuese dhe ligjore.

E drejta e të mësuarit është një nga të drejtat themelore të çjeriut. Procesi i të mësuarit zhvillohet çdo ditë, gjatë tërë jetës, në formë të organizuar ose rastësisht. Përfitimi i diturive dhe të shkathhtësisve të reja i përgatit edhe individët edhe shoqërinë për zhvillim të ambientit jetësor i cili vazhdimisht ndryshon. Arsimit cilësor mundëson përfshirje kompetente të pjesëtarëve të bashkësisë në jetën shoqërore. Në të njëjtën kohë, arsimit jo-cilësor është faktor i përjashtimit social dhe i regresionit ekonomik. Shoqëria e Maqedonisë mund të jetë konkurruese vetëm nëse bëhet shoqëri e cila mëson, krijon dhe aplikon dituri. Parakusht për atë është të përqafohet dhe zhvillohet koncepti i të mësuarit deri në fund të jetës, përkatesisht gjatë tërë jetës. Ky koncept pënkupton arsim efikas të të rriturve në të gjitha nivelet. Të mësuarit dhe arsimi gjatë tërë jetës kontribuon për qasje më të lehtë në informacionet, në të drejtat dhe shërbimet publike. Në atë mënyrë kontribuon për fleksibilitet dhe shkallë më të lartë të punësimit për të gjitha shtresat e popullatës, dhe më atë edhe për inkluzion më efikas social. Prapëseprapë, sipas të dhënave zyrtare nga Enti shtetëror i statistikës nga regjistrimi i fundit të realizuar në vitin 2002, afro 18% nga popullata në R. e Maqedonisë në moshën prej 15 vjet e më lartë, janë analfabet ose nuk e ka të kryer arsimin fillor. Të dhënat janë edhe më brengosëse nëse dihet se vetëm një pjesë e vogël e këtyre njerëzve janë të kucur në procesin e kompletimit të arsimimit. Këto të dhëna fitojnë në peshë kur dihet se në Agjencinë për punësim të R. së Maqedonisë, personat me arsim fillor dhe me arsim të pa kompletuar fillor e zënë përqindjen më të madhe në numrin e tërësishtëm të personave të papunë. Një pjesë e madhe e popullatës së aftë për punë në Republikën e Maqedonisë që është pa arsim fillor në esencë do të mund dhe do të duhej të jetë kontributore e për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik. Këto persona nuk mund ti shijojnë përfitimet të cilat i sjell arsimi dhe nuk mundën në mënyrë kompetente dhe efikase të kycen në jetën shoqërore dhe në tregun e punës. Shikuar në mënyrë afatgjatë, mos arsimim i krijon mos arsimim. Mos arsimim, më shpesh shpien drejt varfërisë, ndërsa varfëria prodhon varfëri. Pa masa efikase sistematike, kjo dukuri zhvillohet në spirale vetë-përtëritëse të regresionit që shkon teposhtë edhe në nivel të shoqërisë edhe në nivel individual.

